

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5559
E shtunë, 25 gusht 2018
çmimi 0.40 €

Këtë vit tre milionë të
huaj kanë zgjedhur
Shqipërinë për turizëm



FAQE 2

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

**NJË IKJE E
PLANIFIKUAR
DHE MBASE E
KOORDINUAR,
BISHTIN E
SHOHIM MË
VONË!** F.10-11



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

**PRESIDENTI THAÇI UDHËTOI
PËR NË AUSTRI, MERR PJESË
NË FORUMIN 'ALPBACH'** F.2

**SHOQATAT E UÇK-SË PËR
DUKAGJIN: TË NDALET
TENDENCA KUNDËR LUFTËS
ÇLIRIMTARE** F.6

**KËSHILLI I PRINDËRVE
KUNDËR GREVËS
SË SBASHK-ut** F.6

EKONOMI

**DEFICITI TREGTAR MË I
LARTË PËR 18.3 PËR QIND NË
MUAJIN KORRIK TË 2018-s** F.8

**PËRFUNDON ME SUKSES
PROGRAMI KEDS KIDS
ACADEMY** F.8

KULTURË

Ç'KEMI NË KËTO 'LULE'? F.13

Sadri FETIU

SPORT

**LLAPI PËR KËNDELLJE NDAJ
BALLKANIT** F.15



FLET PËR "EPOKËN E RE", SHKUMBIN DEMALIAJ

Në bazë të ligjit nuk ka fryrje të listave të veteranëve

Ish-anëtari i Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Veteranit, Shkumbin Demaliaj, ka bërë me dije se në bazë të ligjit dhe dokumentacionit të ofruar, numri prej 60 mijë veteranëve të UÇK-së është i saktë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se nuk ka fryrje të listave meqë, sipas tij, pjesë e listës së veteranëve janë veteranët luftëtarë, veteranët invalidë dhe të internuarit e luftës. Demaliaj ka theksuar se prej 60 mijë veteranëve vetëm 37 mijë prej tyre marrin pensione. Sipas tij, nuk ka veteran të rrejshëm dhe meritator, por ka vetëm veteran. Në këtë kontekst, Demaliaj e ka quajtur banale shifrën prej 19 mijë veteranëve të rrejshëm. Ai i ka bërë thirrje prokurorisë ta kryejë punën e vet dhe ta çojë deri në fund hetimin e listave të veteranëve. Por, sipas Demaliajt, është e papranueshme që kujt t'i teket të flasë dhe ta ofendojë luftën e UÇK-së ■ FAQE 4-5

KËSHILLTARI PËR SIGURI KOMBËTARE NË SHTËPINË E BARDHË,
JOHN BOLTON, ËSHTË DEKLARUAR RRETH IDESË SË SHKËMBIMIT TË
TERRITOREVE NË MES TË SERBISË DHE KOSOVËS

Boltoni: Nuk përjashtojmë korrigjimet territoriale

Këshilltari për Siguri Kombëtare në Shtëpinë e Bardhë, John Bolton, nuk e ka përjashtuar mundësinë e korrigjimit të kufirit në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë. Ai ka thënë se nëse të dyja palët kanë vullnet për një marrëveshje të tillë, ShBA-ja nuk përjashton korrigjimet territoriale. Këshilltari i presidentit amerikan ka deklaruar se Uashingtoni nuk do të përfshihet në idenë për shkëmbim terriroresh në mes të dy vendeve, duke lënë të kuptohet se çdo gjë është në duar të dyja palëve ■ FAQE 3



**Familjarët e
të pagjeturve
kërkojnë
presion ndaj
Serbisë**

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Pritren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Vuçiqi: Beogradi dhe Prishtina nuk janë as afër arritjes së marrëveshjes

BEOGRAD, 24 GUSHT - Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka thënë se Beogradi dhe Prishtina nuk janë fare afër arritjes së marrëveshjes. Sidoqoftë, ai është zotuar se do t'i informojë qytetarët në Serbi nëse marrëveshja arrihet duke e prezantuar atë para opinionit. "Është shumë vështirë të arrijmë çfarëdo marrëveshje. Nuk jemi afër, nuk ka marrëveshje. Se a jemi afër zgjidhjes, nuk jemi, jemi mjaft larg saj. Por, nëse arrijmë një marrëveshje të tillë, unë do t'i informoj qytetarët", ka thënë Vuçiq.


I pyetur nga gazetarët nëse përfaqësuesit shqiptarë nga

komunat Bujanoc, Preshevë dhe Medvegje do të shkojnë në Tiranë për bisedime, Vuçiqi ka pohuar se nuk ka frikë nga bisedimet e tilla për, siç i ka quajtur ai, dëshirat e disave të cilat nuk janë të reja. "Le t'i presim rezultatet dhe kështu mund të shohim se kush çfarë ka fituar e kush çfarë ka humbur. Në marrëveshjen eventuale me shqiptarët duhet ta dimë që të gjithë do të humbim nga pak", ka deklaruar Vuçiq. Ai ka bërë me dije se në ditët e ardhshme do të takohet me kryeministrin e Shqipërisë Edi Rama dhe presidentin e Kosovës, Hashim Thaçin.



McCain ndërpret trajtimin kundër kancerit

WASHINGTON, 24 GUSHT - Senatori republikan amerikan John McCain ka ndërprerë trajtimin kundër kancerit të trurit, 13 muaj pas zbulimit të sëmundjes, ka njoftuar familja e tij. McCain, 81 vjeç, njoftoi në korrik të vitit 2017 se vuan nga kanceri në tru. "Me forcën e tij dhe vullnetin, ai ka zgjedhur ta ndërpresë trajtimin mjekësor", thuhet në deklaratën e familjes McCain.



McCain ishte kandidat për president të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në vitin 2008.



Veseli: Kofi Annan dha kontribut të çmuar për lirinë e Kosovës

PRISHTINË, 24 GUSHT - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, është nënshkruar sot në Librin e zisë për vdekjen e ish-sekretarit të OKB-së, Kofi Annan, i

cili gjatë luftës në Kosovë dha kontribut të çmuar për lirinë e Kosovës. "Me vdekjen e Kofi Annanit bota ka humbur një diplomat dhe një paqedashës humanitar. Institucionet dhe

qytetarët e Kosovës do ta mbajnë mend gjithmonë emrin e ish-sekretarit të OKB-së, Kofi Annan", ka shkruar kryeparlamentari Veseli.

Këtë vit tre milionë të huaj kanë zgjedhur Shqipërinë për turizëm

TIRANË, 24 GUSHT - Shqipërinë e zgjedhën si destinacion pushimesh 20 mijë polakë më shumë se një vit më parë. Për numrin e rritjes polakët janë në vendin e parë me 78 mijë. Sipas shifrave të shtatë muajve të parë të këtij viti, në Shqipëri kanë hyrë tre milionë të huaj, me një rritje prej 12.4 përqindësh, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Grupi më i madh i pushuesve në Shqipëri vazhdojnë të mbeten shtetasit nga Kosova.

Pushuesit polakë janë ata që kanë rritjen më të madhe në numrin e turistëve që kanë vizituar Shqipërinë nga muaji janar deri në korrik të këtij viti. Mbi 33 për qind është rritja vjetore e pushuesve polakë, të cilët, sipas "Instat", llogariten në mbi 78 mijë për shtatë muaj të këtij viti.

Zhvillimi i sektorit të turizmit dhe integrimi i tij me rrjetin e agjen-



cive ndërkombëtare ka bërë që pushuesit të mos vijnë vetëm spontanisht, por edhe në mënyrë të organizuar. Automjete të shumta nga vendi dhe rajoni u janë drejtuar plazheve për të pushuar edhe këtë fundjavë të nxehtë gushti, po trafiku i

ngarkuar e kthen në një sfidë të vërtetë udhëtimin. Duke iu referuar shifrave të "Instat"-it, turistët polakë dominojnë me plazhin e Golemit.

Si numër të përgjithshëm qytetarët e Kosovës zënë vendin e parë me mbi 911 mijë vizitorë.

NATO-ja, stërvitje të përbashkët me anijet shqiptare në Vlorë

TIRANË, 24 GUSHT - Një stërvitje e përbashkët mes NATO-s dhe anijeve shqiptare "Butrinti" dhe "Oriku" është zhvilluar në portin e

Vlorës. Lajmin e ka bërë me dije të premtën ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, e cila ka publikuar në llogarinë e vet në "Facebook"

edhe fotografi nga kjo stërvitje e përbashkët. "Grupi i dytë i përbashkët i NATO-s kundër minave (SNMCMG2) kreu një stërvitje të

përbashkët me anijet shqiptare 'Butrinti' dhe 'Oriku' këtë javë, pas një vizite produktive në portin e Vlorës", ka shkruar Xhaçka.



Këshilltari për Siguri Kombëtare në Shtëpinë e Bardhë, John Bolton, është deklaruar rreth idesë së shkëmbimit të territoreve në mes të Serbisë dhe Kosovës

Boltoni: Nuk përjashtojmë korrigjimet territoriale



Denis Balibouse (Reuters)

Këshilltari për Siguri Kombëtare në Shtëpinë e Bardhë, John Bolton, nuk e ka përjashtuar mundësinë e korrigjimit të kufirit në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë. Ai ka thënë se nëse të dyja palët kanë vullnet për një marrëveshje të tillë, ShBA-ja nuk përjashton korrigjimet territoriale. Këshilltari i presidentit amerikan ka deklaruar se Uashingtoni nuk do të përfshihet në idenë për shkëmbim territorësh në mes të dy vendeve, duke lënë të kuptohet se çdo gjë është në duar të dy palëve

treguar se ShBA-ja është e gatshme ta ndihmojë Kosovën në këtë proces. "Ne jemi gati të ndihmojmë nga distanca apo nga afër. Ne nuk mendojmë se do ta zgjidhim atë (problemin) për ata. Ne mendojmë se ata duhet ta zgjidhin atë vetë", ka thënë Boltoni. Sipas tij, për ShBA-në çështja e arritjes së stabilitetit në Ballkan është shumë e rëndësishme për ne. Ai ka deklaruar se prej kohës së shpërbërjes së Jugosllavisë ka pasur shumë tensione dhe rreziqe.

Duke iu referuar arritjes së marrëveshjes rreth kontestit të emrit në mes të Maqedonisë dhe Greqisë, Bolton ka thënë se ka pasur edhe zhvillim. "Mosmarrëveshja në mes të Kosovës dhe Serbisë mund të jetë një nga çështjet më të rëndësishme. Shumë njerëz kanë tentuar të ndërmjetësojnë. Këto përpjekje kanë dështuar", është shprehur ai.

Pas fillimit të fazës finale të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe homologu i

tij serb, Aleksandar Vuçiq, kanë hedhur ide të ndryshme për përmbylljen e procesit të normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet të dy shteteve.

Presidenti serb ka hedhur idenë e ndarjes ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve, ndërsa presidenti Thaçi është deklaruar pro korrigjimit të kufijve me Serbinë, ashtu që Kosova t'i marrë komunat shqiptare të Luginës së Preshevës. Madje, presidenti Thaçi ka thënë se shkëmbimin e territoreve e kishte përmendur edhe ish-presidenti i Kosovës, Ibrahim Rugova. "Jo ndarje të Kosovës, por po shkëmbimit të territoreve", ky ishte qëndrimi realist dhe i guximshëm i presidentit Ibrahim Rugova në vitin 1994. Ndërsa, qëndrimi im sot si president i Republikës së Kosovës ka evoluar dhe është i qartë: jo ndarje, jo shkëmbim, po korrigjimit të kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, për ta mundësuar bashkëngjitjen e Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës me Kosovë", ka shkruar Thaçi në profilin e vet

në "Facebook".

Por ky pretendim i presidentit të vendit është kundërshtuar nga zyrtarët e lartë të LDK-së, duke thënë se ish-presidenti Rugova kurrë nuk e ka përkrahur idenë e shkëmbimit të territoreve. Si përgjigje ndaj këtyre reagimeve, presidenti Thaçi të premten ka postuar në profilin e vet në "Facebook" fakte ku Rugova flet për këtë ide. "E pritshme! Me përjashtime të vogla, disa prej atyre që e promovojnë vetën bashkëpunëtorë të presidentit Ibrahim Rugova, po vërtetohet që atëherë, as nuk i kanë dëgjuar, as nuk i kanë kuptuar qëndrimet dhe deklaratat e tij. Së paku, le ta bëjnë një gjë të tillë sot. Më poshtë lexoni një pjesë të shkëputur nga intervista e presidentit Ibrahim Rugova dhënë më 1994 për gazetën "Zëri", ka shkruar Thaçi.

Idenë e shkëmbimit dhe të korrigjimit të territoreve në mes të dy vendeve e kanë kundërshtuar shtetet më të fuqishme evropiane.

EPOKA ERE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 24 GUSHT - Këshilltari për Siguri Kombëtare në Shtëpinë e Bardhë, John Bolton, ka thënë të premten në Kiev se Uashingtoni nuk do të përfshihet në idenë për shkëmbim territorësh në mes të Kosovës dhe Serbisë. I pyetur nga "Radio Evropa e Lirë" për këtë çështje, ai ka thënë se nëse të dyja palët janë për një marrëveshje të tillë, ShBA-ja nuk përjashton korrigjimet territoriale. "Unë mendoj se ka shenja të reja se të dyja qeveritë mund të kenë vullnet për të negociuar

këtë çështje në heshtje. Politika jonë, politika amerikane është që, nëse të dyja palët mund të punojnë me njëra-tjetrën për të arritur një marrëveshje, ne nuk përjashtojmë korrigjimet territoriale. Nuk na takon neve", ka thënë Bolton. Ai ka bërë me dije se askush nuk do ta kundërshtojë një ujdë në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Nuk do të jemi pengesë, dhe nuk mendoj se dikush në Evropë do të qëndrojë në mes, nëse të dyja palët në konflikt arrijnë një marrëveshje të kënaqshme", është shprehur ai.

Këshilltari i presidentit amerikan, John Bolton, ka

Ministri Bytyqi fton nxënësit dhe studentët t'i bashkohen aksionit për pastrimin e Kosovës



PRISHTINË, 24 GUSHT (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, në mbështetje të nenit 4, 21 dhe 22 të

Ligjit nr.03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, ka marrë vendim, me të cilin obligohen të gjithë nxënësit dhe studentët

që më 15 shtator të ndihmojnë në pastrimin e të gjitha hapësirave përreth objekteve edukative arsimore. Ndërsa në pikën dytë po këtij vendi-

mi obligohen të gjitha drejtoritë komunale të arsimit që ta hartojnë një plan për mbjelljen e pishave në oboret e shkollave.

Flet për "Epokën e re", Shkumbin Demaliaj

Në bazë të ligjit nuk ka fryrje

Ish-anëtari i Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Veteranit, Shkumbin Demaliaj, ka bërë me dije se në bazë të ligjit dhe dokumentacionit të ofruar, numri prej 60 mijë veteranëve të UÇK-së është i saktë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se nuk ka fryrje të listave meqë, sipas tij, pjesë e listës së veteranëve janë veteranët luftëtarë, veteranët invalidë dhe të internuarit e luftës. Demaliaj ka theksuar se prej 60 mijë veteranëve vetëm 37 mijë prej tyre marrin pensione. Sipas tij, nuk ka veteran të rrejshëm dhe meritë, por ka vetëm veteran. Në këtë kontekst, Demaliaj e ka quajtur banale shifrën prej 19 mijë veteranëve të rrejshëm. Ai i ka bërë thirrje prokurorisë ta kryejë punën e vet dhe ta çojë deri në fund hetimin e listave të veteranëve. Por, sipas Demaliajt, është e papranueshme që kujt t'i tekjet të flasë dhe ta ofendojë luftën e UÇK-së

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 24 GUSHT -

"Epoka e re": Z. Demaliaj, ditët e fundit ka nisur një debat rreth numrit të veteranëve të UÇK-së. Është i saktë numri prej 60 mijë veteranëve të luftës së UÇK-së?

Demaliaj: Si ish-anëtar i Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Veteranit pretendoj se ky numër është i saktë në bazë të ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe në bazë të dokumentacionit që ish-luftëtarët e UÇK-së kanë ofruar në sekretarinë e Komisionit.

"Epoka e re": Sipas jush, s'ka fryrje të listave?

Demaliaj: Në bazë të ligjit, nuk ka fryrje të listave, përkundrazi është numër shumë i vogël në raport me ata që kanë aplikuar. Ky ligj luftën e UÇK-së e parasheh si luftë vullnetare, do të thotë UÇK-ja ka bërë luftë vullnetare dhe në bazë të këtij vullneti është ky numër. Nëse në të ardhmen ligji ndryshon, luftën e bën të obligueshme dhe e përcakton kohëzgjatjen e njerëzve në luftë dhe është krejt diçka tjetër. Meqenëse ligji aktual luftën e parasheh vullnetare, të gjithë ata njerëz që kanë marrë pjesë në luftë jo vazhdimisht, për shkak se kemi pasur lëvizje të mëdha të ushtarëve në zona të ndryshme, këtu flas për Zonën e Dukagjinit, me këtë ligj të gjithë janë veteranë.

"Epoka e re": Por nga një hetim i prokurorisë rezultojë 19 mijë

veteranë janë të rrejshëm.

Demaliaj: Nuk flas për këto hetime. Ish-prokurori i kësaj lënde ka gabuar që ka nxjerrë në publik hetimet duke i dhënë mundësi gjithkujt të flasë për këtë çështje. Dokumentacioni është në prokurori, në qeveri dhe në duart e komandantëve. Madje kam bërë kërkesë që krejt puna e Komisionit, transkriptimet dhe procesverbalet të bëhen publike, dhe jo kujt t'i tekjet të flasë çfarëdo.

"Epoka e re": Edhe drejtuesit e UÇK-së po thonë se ka fryrje të listave. Madje ish-komandanti i përgjithshëm i UÇK-së, Sylejman Selimi, ka thënë se pas luftës janë identifikuar rreth 13 mijë ushtarë.

Demaliaj: Pas luftës janë mbledhur disa shifra të ushtarëve që kanë kaluar në TMK. Për atë numër flet Selimi. Si komision kemi kërkuar të na vijë dokumentacioni i arkivit të UÇK-së dhe TMK-së, por kanë thënë se dokumentacioni është lagur dhe nuk mund të nxirret diçka prej tij. Nuk kemi pasur dokumentacion as nga shoqatat e dala nga lufta. Pra, si komision kemi punuar në bazë të aplikacioneve që i kanë ofruar ish-luftëtarët.

"Epoka e re": Duke pasur parasysh se keni shërbyer në Zonën Operative të Dukagjinit dhe e njihni atë pjesë, a ka persona që e kanë marrë statusin e veteranit pa meritë, për arsye të ndryshme dhe vota?

Demaliaj: Sa i përket Zonës së Dukagjinit, e di se ka edhe shumë njerëz që e meritojnë të jenë pjesë e listave në bazë të



ligjit ekzistues, por nuk kanë aplikuar të gjithë kontribuuesit e luftës. Zona e Dukagjinit vetëm në qershorin e vitit 1998 i ka pasur mbi 17 mijë njerëz. Pra, kanë qenë mbi 17 mijë pushkë në Zonën e Dukagjinit që kanë hyrë nga Shqipëria. Ka pasur lëvizje të ushtarëve dhe Brigada 131, Brigada 133 dhe Brigada 134 e Ministrisë së Mbrojtjes, të udhëhequra nga Rustem Berisha dhe Tahir Zemaj, e kanë lëshuar luftën në shtator të vitit 1998. Nëse ata njerëz që kanë luftuar për gjashtë muaj dhe janë tërhequr me urdhër të Ministrisë së Mbrojtjes nuk duhet të jenë veteranë, atëherë për këtë lë të flasim përfaqësuesit e tyre, lë të flasim përfaqësuesit e LDK-së që po kanë dëshirë t'i japin konotacion tjetër kësaj lëvizje. Nëse mendohet se ata nuk

meritojnë të jenë pjesë e këtyre listave, edhe unë jam i gatshëm që lista të minimizohet. Ata janë njerëz që kanë marrë pjesë pesë ose gjashtë muaj në luftë dhe thuhet se janë tërhequr me urdhër të ministrit të Mbrojtjes. Nëse konsiderohet se duhet të minimizohet lista në këtë mënyrë, atëherë është gabim i madh, sepse ushtarët e UÇK-së nuk duhet të dallohen me pjesëmarrje në luftë.

"Epoka e re": Sa është numri i saktë i veteranëve të Zonës së Dukagjinit?

Demaliaj: Nuk jam i sigurt për numrin sepse si komision nuk kemi njësuar numra, por kjo është publike dhe mund ta gjeni në sekretarinë e komisionit për secilën brigadë për komandën e zonës. Vetëm në përfundim të luftës kanë qenë

tetë brigada dhe komanda e zonës në Zonën e Dukagjinit me të gjitha njësitë e tjera varëse. E di krejt bota sa ushtarë kanë qenë e lëre më Kosova, mirëpo po bëhet politikë me këta njerëz. Veteranët nuk janë pjesë e votës, sepse veteranët janë të të gjitha partive politike. Me këtë po pretendohet të pengohen proceset politike dhe puna e Qeverisë Haradinaj. Verifikimi i veteranëve nuk ka ndodhur në kohën e Qeverisë Haradinaj, por në Qeverinë Thaçi - Mustafa. Materiali është në prokurori dhe prokuroria duhet t'i ndjekë hetimet deri në fund.

"Epoka e re": Ka qenë i panevojshëm hetimi i listave?

Demaliaj: Nuk përzihem në punët e prokurorisë. Nëse edhe

e të listave të veteranëve



fundim të luftës të kenë një pension deri 170 euro, ndërkaq të tjerëve që e kanë ndërprerë luftën më herët të kenë një pension 120 euro, por në këtë rast prokuroria ka ndërhyrë dhe e ka marrë materialin e arkivuar të kësaj liste në qeveri, dhe nuk ka mundur të zbatohet pjesa e plotësimndryshimit të ligjit të miratuar nga Kuvendi më 30 dhjetor të 2016-s. Sa i përket punës së komisionit, jam i gatshëm të ballafaqohem me çfarëdo drejtësie personalisht lidhur me Zonën e Dukagjinit dhe për secilin aplikant veç e veç, sepse atë status ua ka ofruar ligji. Po flasim për 60 mijë njerëz, por e dimë se 37 mijë marrin pensione, mirëpo janë 4-5 kategori të veteranëve në ato lista dhe që një pjesë e tyre nuk ka të drejtë në pension. Janë veteranët luftëtarë, veteranët pjesëtarë, veteranët pjesëmarrës, veteranët e internuar të luftës dhe veteranët invalidë të luftës. Kur krejt futen në një thes, të gjithë këta janë veteranë dhe askush nuk mund t'ua mohojë këtë të drejtë.

"Epoka e re": Me zhvillimet e fundit, a po degradohet lufta e UÇK-së?

Demaliaj: Asnjë milimetër nuk mund të degradohet lufta e UÇK-së. Secili ushtar që ka pasur pushkën në dorë e di se nuk mund ta degradojë askush kontributin e tij për çlirimin e vendit. Ndërkaq të gjithë ata që dalin dhe flasin le ta dinë se UÇK-në nuk mund ta thyejë askush, sepse është e vetmja emblemë që e ka bërë Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. E dimë se që nga themelimi i UÇK-së ka pasur zëra të politikës së atëhershme se UÇK-ja nuk ekziston, e më vonë kanë thënë se UÇK-ja është dorë e zgjatur e Serbisë. Por mekanizmin që ka bashkëpunuar vazhdimisht me Serbinë e pengon kjo gjeneratë e artë që ka ndikuar që bashkë me aleatët ta çlirojnë dhe ta bëjnë Kosovën shtet.

"Epoka e re": Z. Demaliaj, si është e mundur të vihet deri tek e vërteta dhe listat t'i përmbajnë vetëm veteranët e vërtetë?

Demaliaj: Të lutem, nuk ka dy të vërteta, është vetëm një e vërtetë. Aplikacionet janë bërë sipas ligjit dhe dokumentacioni është në sirtarët e qeverisë dhe prokurorisë dhe nuk ka dy të vërteta mbi ato dokumente. Secilin veç e veç le ta shpalosin dhe le ta bëjnë publik, por mos ta kryqëzojnë askënd lidhur me këtë temë për shkak se po ndihemi të ofenduar vazhdimisht

para familjes, njerëzve dhe para opinionit sikur ka ndodhur një shkelje e madhe. Janë banale ato shifra që po thuhet për veteranë të rrejshëm. Është turpi më i madh t'i thuhet dikujt veteran i rrejshëm. Nëse dikush është në listë, por nuk ka qenë në luftë, ai është kriminel, sepse ka fituar një status pa të drejtë ligjore dhe pa kontribut. Ndërkaq veteranët janë veteranë. Nuk ka veteran të rrejshëm dhe veteran meritot.

"Epoka e re": Në lista ka kësi 'kriminelë', siç po i quani ju?

Demaliaj: Nuk e di. Ne kemi shqyrtuar dokumentacion. Nëse dikush ka ofruar dokumentacion të rrejshëm dhe ka fituar statusin pa të drejtë le të hetohet. Si komision nuk kemi pasur t'i bëjmë gjyq askujt. Secili e gëzon statusin pasi që

aplikacioni i tij është verifikuar dhe ka qenë i nënshkruar nga zinxhiri komandues. Është e padrejtë të spekulohet me javë të tëra lidhur me diçka të ngjashme. Nëse duan ta ndryshojnë ligjin, kjo mund të bëhet në të ardhmen, por ka për të qenë e komplikuar. Nëse një luftëtar hiqet për shkak se ka pasur kohëzgjatje më pak se të tjerët është turp.

"Epoka e re": Si e keni parë parajlmërimin se këtyre 19 mijë veteranëve të rrejshëm mund t'u ndërpritet pensioni?

Demaliaj: Është detyrë e prokurorisë dhe gjyqësisë t'i bëjë hetimet, kurse sa i përket punës sime në komision, jam i gatshëm të paraqitem para çfarëdo drejtësie, para qytetarëve dhe para ligjit mbi bazën e të cilit kemi punuar.

për një rast të vetëm konsiderohet se ka pasur shkelje duhet të trajtohet nga prokuroria, por nuk mund të bëhet as hetim e as kurgjë kur njerëzit nuk janë të gatshëm ta kryejnë detyrën e vet. E jo të dalin të krijojnë këso maskaradash në opinionin publik. Që dy javë askush nuk është ka merret me çështjet e tjera përpos me diçka që ka ndodhur 20 vjet më herët. Kjo duhet të jetë temë e prokurorisë, e gjyqësisë dhe njerëzve përgjegjës dhe jo kujt t'i teket ta ofendojë UÇK-në, vlerën më të madhe kombëtare që ka pasur Kosova ndonjëherë.

"Epoka e re": Do të pranoni çfarëdo procesi të hetimit?

Demaliaj: Kam qenë i intervistuar nga ish-prokurori Blakaj. Jam i gatshëm sërish të intervistohem apo të hetohem për këtë çështje për shkak se bashkë me anë-

tarët e tjerë të komisionit e kam kryer punën në bazë të ligjit në fuqi. Këta po harrojnë dhe askush nuk po e përmend se të gjithë të internuarit e luftës dhe ata që kanë qenë të burgosur nga Serbia në vitet 1998-1999 janë në listat e veteranëve. Askush nuk po e trajton problemin në bazë të ligjit.

"Epoka e re": Ligji qenka fajtor për rritjen e numrit të veteranëve?

Demaliaj: Ligji nuk është fajtor, sepse atë e ka bërë Kuvendi. 17 vjet nuk ka pasur ligj, ndërkaq brenda një viti janë bërë dy ligje. Ligji i dytë ka hyrë në fuqi, por për shkak se prokuroria ka bërë hetim lidhur me këtë çështje, nuk ka mundur të zbatohet. Ka pasur të bëjë me çështjet financiare lidhur me pensionin për disa pjesëtarë që kanë marrë pjesë deri në për-

Presidenti Thaçi udhëtoi për në Austri, merr pjesë në forumin 'Alpbach'

PRISHTINË, 24 GUSHT (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka udhëtuar të premten për në Austri, ku do të marrë pjesë në forumin evropian në "Alpbach" të Austrisë. Me ftesë të presidentit të Austrisë, Alexander Van der Bellen, presidenti Thaçi, së bashku me krerët e shteteve të rajonit dhe të Bashkimit Evropian, do të jetë pjesë e një takimi të përbashkët. Gjatë qëndrimit atje presidenti Thaçi do të marrë pjesë

edhe në aktivitetin me temën "Perspektiva të reja për zgjerimin e BE-së". Ai do të zhvillojë takime edhe me përfaqësues të lartë të Bashkimit Evropian, si dhe me personalitete të ndryshme të jetës publike dhe politike në Evropë. Forumi "Alpbach" në Austri është ndër institucionet më prestigjioze që mbledh çdo vit liderë, nobelistë, akademikë, shkencëtarë dhe personalitete të ndryshme nga mbarë bota.



Shoqatat e UÇK-së për Dukagjin: Të ndalet tendenca kundër luftës çlirimtare



EPOKA E RE **Arbisa SHEFKIU**

DEÇAN, 24 GUSHT - Shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së, degët e Dukagjinit: Deçan, Pejë, Gjakovë dhe Istog, kanë reaguar rreth debatit që po bëhet për numrin e veteranëve të UÇK-së. "Kemi përcjell me shqetësim debatin që po ndodh rreth luftës çlirimtare dhe tendencës për degradimin e saj nga faktorë të ndryshëm, të cilët, si duket, po veprojnë më të sinkronizuar se kurrë më parë. Sa i përket debatit rreth luftës në Dukagjin, ne duhet ta rikujtojmë opinionin për faktet në vijim: Lufta në Dukagjin nisi më 24 mars 1998, që i bie një vit para bombardimeve të NATO-s dhe pas shtimit të saj, që nga prilli 1998 nuk ka asnjë ditë në të cilën nuk ka rënë të paktën një dëshmor. Janë 920 dëshmorë që ranë në ZO të Dukagjinit, e një e treta e tyre pikërisht si pjesëtarë të shtabeve lokale që u themeluan pothuajse në të gjitha vendbanimet në komunat e

Dukagjinit. Rreth 1 650 luftëtarë mbetën të plagosur në frontet e luftës. Vlen të përmendet se vetëm fshati Glllogjan dha 27 dëshmorë", është thënë në reagimin e shoqatave të luftës së UÇK-së, të degëve të Dukagjinit. Në këtë reagim thuhet se, përpos shtabeve lokale në të cilat u mobilizuan i madh e i vogël, janë tetë brigada që vepruan në territorin e Dukagjinit, që kanë qenë tmerr i armikut, me çfarë vërtetohet edhe nga librat dhe dokumentarët e realizuar nga vetë serbët, pjesëmarrës të luftës apo gazetarë. "Për shkak të humbjeve që i pësonin në terren nga UÇK-ja, forcat jugosllave kryen në Dukagjin masakrat e tmerrshme në civilë, si në Meje, Lybeniq, Qyshk, Beleg e në shumë lokacione të tjera, duke ekzekutuar mijëra civilë të paarmatosur. Gjithashtu, Peja, Deçani, Istogu e Gjakova, prijnë si qytete në Kosovë, për sa i përket shkallës së shkatërrimit, e cila arrin deri në 74 për qind", është theksuar në këtë reagim. Shoqatat e dala nga lufta e UÇK-

së, degët e Dukagjinit, vlerësojnë se të gjitha këto fakte mbështesin argumentin e ashpërsisë së luftës që u zhvillua në Dukagjin. "Nëse dikush mendon se tërë këtë luftë e bënë një grusht njerëzish, atëherë gabohet, sepse mobilizimi i cili arriti kulmin në qershor të vitit 1998, grumbulloi

dhjetëra mijëra luftëtarë me armë në dorë të cilat siguroheshin me vështirësi në rrugën e gjatë nëpër Bjeshkët e Nemuna. Si përfundim, shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së në Dukagjin kërkojnë ndaljen e kësaj tendence të rrezikshme kundër luftës çlirimtare dhe janë në

përkrahje të plotë të deklaratave të komandantit të ZO të Dukagjinit, Ramush Haradinaj, në dobi të këtij debati, për numrin e veteranëve dhe të gjitha çështjet e tjera të ngritura", është thënë në reagimin e shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, degët e Dukagjinit.

Vlera Gjakova i bashkohet Lëvizjes Vetëvendosje

PRISHTINË, 24 GUSHT (ER) - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka bërë me dije se Vlera Gjakova vjen nga Shkupi, ku shkollën fillore dhe të mesme i ka kryer në gjuhën shqipe, turke e maqedone, më pas atje i ka përfunduar edhe studimet universitare për gazetari e ekonomi. "Tash në Selanik të Greqisë po studion për filozofi në Universitetin Shtetëror 'Aristotelis'. Si aktiviste e të drejtave të njeriut dhe atyre civile, si feministe dhe publiciste, anëtarësimi i Vlera Gjakovës në Lëvizjen tonë na e shton energjinë dhe dijen për punët e aktivitetet që na presin drejt fitoreve të reja", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook".



Këshilli i Prindërve kundër grevës së SBASHK-ut

PRISHTINË, 24 GUSHT (ER) - Këshilli i Prindërve të Kosovës ka shprehur shqetësimin në lidhje me paralajmërimin e SBASHK-ut për të hyrë në grevë nga muaji shtator. Përmes një komunikate për media ky këshill ka njoftuar

se nuk është kundër realizimit të kërkesave për ndryshimin e Projektligjit për pagat dhe miratimin e ligjit për kontributin e viteve të '90-ta, mirëpo ndërprerja e procesit mësimor, sipas tyre, po dëmton interesin e

nxënësve për arsimim. Këshilli i Prindërve ka kërkuar bashkëpunim më të madh dhe u ka bërë thirrje SBASHK-ut dhe Qeverisë që të arrijnë marrëveshje në mënyrë që të mos ndërpritet procesi mësimor.

Haradinaj dhe O'Connell, marrëveshje për rekrutimin për pozita të larta drejtuese



dhe duke konsoliduar transparencën, meritokracinë dhe qeverisjen e mirë", është shprehur kryeministri Haradinaj, duke vlerësuar se deri më tani janë gjithsej 21 pozita të larta drejtuese të realizuara përmes partneritetit me Ambasadën Britanike për dy vjetët e fundit. Kryeministri Haradinaj ka pohuar se ky proces do të vazhdojë edhe më tutje me listën e re me gjithsej 22 pozita, të cilat do të realizohen në periudhën e ardhshme. "Jemi me fat që ekspertizën shumëvjeçare britanike e kemi dhuratë dhe këtë duhet ta çmojmë dhe nderojmë me punë të mirë dhe të ndershme. Vetëm në këtë mënyrë nderojmë veten, atdheun dhe miqtë e vjetër të Kosovës, siç është Britania e Madhe", ka thënë kryeministri Haradinaj. Ambasadori britanik O'Connell ka thënë se ky projekt siguron që fazat e rekrutimit të kalohen vetëm nga njerëzit meritorë. "Ky projekt siguron që njerëzit meritorë të kalojnë fazat e rekrutimit dhe emërimi bëhet nga Qeveria. Për këtë, sukcesi i këtij projekti do të jetë sukses i Kosovës dhe dëshimi i projektit është dëshim për Kosovën", ka thënë ai. O'Connell ka shtuar se në tri raste janë emëruar persona që nuk kanë përmbushur kriteret për rekrutim në pozita të larta. Ai ka thënë se projekti mund të konsiderohet i suksesshëm vetëm kur u jepet hapësirë profesionistëve të punojnë pa frikë.

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 GUSHT - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj dhe ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Ruairi O'Connell, kanë nënshkruar të premtën memorandumin e mirëkuptimit në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të

Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, e përfaqësuar nga Ambasada Britanike në Prishtinë. Qëllimi i memorandumit të mirëkuptimit është të mbështetja e përpjekjeve të përbashkëta për të siguruar që të emërohen udhëheqës të fortë, të pavarur dhe profesionalë të institucioneve dhe organeve publike përmes një procesi të drejtë dhe transparent të rekrutimit. Ky pro-

jekt synon t'i ndihmojë institucionet e Kosovës për rekrutimin e një liste të dakorduar të pozitave të larta. Pas nënshkrimit të memorandumit, kryeministri Haradinaj dhe ambasadori O'Connell u prononcuan për media.

Kryeministri Haradinaj me këtë rast ka thënë se po vazhdohet partneriteti me Britaninë e Madhe, si shtet mik i Kosovës në

të gjitha proceset e rëndësishme të saj, tani edhe duke përkrahur objektivin e kësaj Qeverie për fuqizimin e qeverisjes së mirë, transparencës dhe llogaridhënies në institucionet publike. "Përmes një partneri implementues britanik, ambasada ka ndihmuar kthimin e besimit në organet publike, por edhe rekrutimin në pozita të larta të shërbimit civil, duke parandaluar nepotizmin

Familjarët e të pagjeturve kërkojnë presion ndaj Serbisë

EPOKA
ERE

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 24 GUSHT - 30 gushtin - Ditën Ndërkombëtare për Persona të Zhdukur, Kosova do ta shënojë me marsh në sheshet e kryeqytetit, ku do të kërkohet zbardhja e fatit dhe kthimi i 1 648 personave që prej nga pas lufta figurojnë të pagjetur. Kështu është bërë me dije pas takimit të Këshillit Organizativ për shënimin e kësaj date, prej ku u kërkua më shumë presion nga spektri ndërkombëtar ndaj Serbisë lidhur me këtë çështje.

Këshilltari i kryeministrit Ramush Haradinaj, Jahja Lluka, ka thënë se kjo temë është prioritet i Qeverisë së Kosovës. "Do të tubohemi me familjarët në Sheshin 'Zahir Pajaziti' dhe do të bëjmë një ecje drejt obeliskut i cili është në oborrin

e Kuvendit, ku do të bëjmë homazhe, kurse Sheshi 'Nëna Terezë' do të jetë i mbuluar me disa shenja të këmbëve të të zhdukurve, me sloganin 'Ku janë?', si dhe do të ketë edhe aktivitete të tjera", ka thënë Lluka.

Nysrete Kumnova, anëtare e komisionit qeveritar për të pagjeturit, ka thënë se kjo datë shënohet në krejt botën, duke kujtuar se zhdukjet nuk kanë ndodhur vetëm në Kosovë, por në gjithë botën. Ajo tregoi se 19 herë ishin në Merdare dhe se vazhdimisht kanë pasur përkrahjen e vazhdueshme të familjarëve. Kumnova u tregua e qartë kur drejtoi gishtin kah adresa e të pagjeturve. "Adresa e më të dashurve tanë është Serbia, por i mungon presioni. Unë mendoj se presioni ndërkombëtar mungon", ka thënë Kumnova.



KPK-ja marrëveshje edhe me Vitinë për implementimin e 'Programit për trajnimin në punë'

Klubi i Prodhuesve të Kosovës (KPK) ka nënshkruar marrëveshje me Komunën e Vitisë për realizimin e programit të financuar nga USAID-i që synon ta mbështesë trajnimin dhe punësimin e të rinjve

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 24 GUSHT - Klubi i Prodhuesve të Kosovës (KPK) ka nënshkruar të premten një marrëveshje të mirëkuptimit me Komunën e Vitisë për fillimin e implementimit të "Programit për trajnimin në punë", program ky i cili mbështetet financiarisht nga projekti i USAID-it, EMPOWER sektori privat, në partneritet me Agjencinë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, Sida. Programi për trajnimin në punë ka për qëllim t'i mobilizojë kompanitë në sektorin privat që të angazhohen në mënyrë më aktive për trajnimin e të rinjve ekonomikisht dhe aftësimin e tyre profesional. Për këtë arsye, KPK-ja së bashku me partnerët nga sek-

tori privat ka filluar implementimin e këtij programi, i cili është i strukturuar për zhvillimin e aftësive profesionale tek të rinjtë dhe për rritjen e mundësisë së punësimit të tyre. Në Komunën e Vitisë përfituesit e parë të këtij programi do të jenë të rinjtë, të cilët do të trajnohen në punë përmes angazhimit në kompani. Në përfundim të trajnimeve pritet që disa prej përfituesve do të kenë mundësi të punësohen tek kompanitë partnere prodhuese të Klubit. Kandidatët do të përfitojnë nga një program trajnimi i kualifikuar dhe i strukturuar për nevojat e tregut të punës. Kryetari i Komunës së Vitisë, Sokol Haliti, ka mirëpritur fillimin e implementimit të këtij programi dhe ka shprehur gatishmërinë që ta sigurojë mbarëvajtjen e programit. Komunitat e tjera përfituese



nga ky program janë edhe Kaçaniku, Gjilani dhe Hani i Elezit. Gjatë javëve në vazhdim, Klubi i

Prodhuesve të Kosovës do të njoftojë se kur do të hapen aplikimet për përzgjedhjen e kandidatëve në këto komuna. Një

marrëveshje të njëjtë Klubi i Prodhuesve të Kosovës (KPK) ka nënshkruar të enjten edhe me Komunën e Kaçanikut.



Përfundon me sukses programi KEDS Kids Academy

PRISHTINË, 24 GUSHT (ER) - Rreth 150 fëmijë kanë përfunduar mësimet në kursin e KEDS Kids Academy. Ky projekt është zhvilluar nga Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS). Në kuadër të projektit janë trajnuar fëmijët 7 deri në 10 vjeç të punëtorëve të KEDS-it të distriktit të Prishtinës.

Ligjëratat janë ndarë në disa grupe dhe janë zhvilluar gjatë muajve

korrik dhe gusht, në kohën kur fëmijët janë në pushime verore. Fëmijët kanë mësuar si të programojnë, si të dizajnojnë çarçe dhe të montojnë pajisje elektronike. Ata përmes ligjëratave dhe ushtrimeve mësuar si funksionon Arduino, që është një platformë e cila përdoret për ndërtimin e projekteve në elektronike dhe robotikë.

Drejtoresha për komunikime në KEDS, Naxhije Arifaj, ka thënë

fëmijët që kanë marrë pjesë në këtë program kanë treguar interesim mjaft të madh që të marrin njohuri të reja në këtë fushë. Fëmijët kanë vizituar edhe laboratorët e KEDS-it dhe nga afër kanë mësuar se si funksionojnë njehsorët elektrikë. Përkrahja e komunitetit në fushën e edukimit mbetet angazhim i përhershëm i KEDS-it, i filluar që nga koha kur kompania kishte nisur operimet, përmes programit të KEDS Academy.

Rukiqi dhe ambasadori italian diskutojnë për thellimin e bashkëpunimit

PRISHTINË, 24 GUSHT (ER) - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, ka pritur të premten në takim ambasadorin e Italisë në Kosovë, Piero Cristoforo Sardi dhe zëvendësambasadorin Matteo Corradini, ku u diskutuan ide konkrete për thellimin e bashkëpunimit në sferën ekonomike në mes dy shteteve. Me theks të veçantë u fol për rëndësinë e forcimit të sundimit të ligjit, përmirësimin e imazhit të Kosovës dhe përmirësimin e ambientit të të bërit biznes që

ndikon pozitivisht edhe tek investimet e huaja dhe partneritetet e bizneseve të Kosovës me kompanitë e ndryshme evropiane dhe më gjerë.

Kryetari i OEK-ut, Berat Rukiqi, ka pohuar se institucioni që drejton është gjithmonë i gatshme t'i ndihmojë bizneset vendore për krijimin e partneriteteve ndërkombëtare në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe avancimit të rolit të sektorit privat si garantues i rritjes ekonomike.



Kosova, pjesë e konferencës bujqësore në Maribor



PRISHTINË, 24 GUSHT (ER) - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Nenad Rikalo, me ftesë të zëvendëskryeminitrit, njëherësh ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ushqimit të Republikës së Sllovenisë, Dejan Zidan, po merr pjesë në Konferencën Ndërkombëtare Ministrore me temë "Zonat rurale dhe bujqësia si një mundësi për njerëz të rinj",

e cila po mbahet në Maribor të Sllovenisë.

Kjo konferencë do të fokusohet në rëndësinë e fermerëve të rinj dhe rinovimin e gjeneratave për të ardhmen e bujqësisë evropiane dhe sigurimin e sigurisë ushqimore, ndërsa janë të ftuar të marrin pjesë ministrat e bujqësisë të vendeve anëtare të BE-së, vendeve candidate dhe kandidatëve potencialë për pranim në

BE, si dhe Këshilli Evropian i Fermerëve të Rinj (CEJA).

Gjatë diskutimit në këtë konferencë ministrat do të shkëmbejnë mendime rreth asaj se si t'i ndihmojnë të rinjtë në fshatra për ta bërë mjedisin më miqësor, në mënyrë që më shumë të rinj të vendosin të jetojnë në zonat rurale dhe të punojnë si fermerë dhe si të krijojnë një mjedis më stimulues

për gratë e reja që jetojnë në ato zona. Diskutimi, gjithashtu, do ta adresojë digitalizimin në bujqësi. Aplikimi i mjeteve dhe teknologjive të reja të informacionit, bazave të të dhënave dhe inovacioneve, mendohet se çon në një konkurrencë më të madhe, menaxhim më të mirë dhe reduktim të ngarkesave administrative. Ministrat do ta shkëmbejnë përvojën në lidhje me transferimin e

teknologjive të informacionit në bujqësi dhe rolin që fermerët e rinj luajnë në këtë aspekt. Ministri Rikalo, në një takim të veçantë me ministrin Zidan, biseduan për mundësitë e bashkëpunimit për avancimin e politikave bujqësore. Rikalo ka theksuar se Sllovenia është partnere shumë e mirë ekonomike dhe politike e Republikës së Kosovës.

Deficiti tregtar më i lartë për 18.3 për qind në muajin korrik të 2018-s

EPOKA
ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 24 GUSHT - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat lidhur me rrjedhat e eksportit dhe importit për muajin korrik 2018. Të dhënat nga tregtia e jashtme në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar më të lartë për 18.3 për qind në muajin korrik 2018, në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2017, gjegjësisht në vlerë prej 280,2 milionë eurosh krahasuar me deficitin prej 236,9 milionë eurosh në vitin 2017. Eksporti mbulon importin me 9.3 për qind. "Eksporti i mallrave në muajin korrik 2018 kishte vlerën 28,7 milionë euro, ndërsa importi 309 milionë euro, ku është një rënie prej -25 përqindësh për eksport dhe një rritje prej 12.2 përqindësh për import, duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017", thuhet në publikimin e ASK-së. Sipas të dhënave të grupeve kryesore të eksportit: 31.3 për qind të eksporteve e përbëjnë

metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 13.7 për qind e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 13.5 për qind e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 12.5 për qind e përbëjnë produktet minerale; 8.5 për qind e përbëjnë produktet bimore; 3.1 për qind e përbëjnë tekstili dhe artikujt prej tij; 2.9 për qind e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 2.8 për qind e përbëjnë lëkura dhe artikujt prej tyre etj.

Ndërsa, sipas të dhënave të grupeve kryesore për import: 14.4 për qind e përbëjnë produktet minerale; 14.1 për qind e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 12.6 për qind e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 11 për qind e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 7.4 për qind e përbëjnë mjetet e transportit; 6.8 për qind e përbëjnë produktet e industrisë kimike; 6.3 për qind e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 4.3 për qind e përbëjnë tekstili dhe artikujt prej tij etj. "Eksportet e



Kosovës në vendet e BE-së arritën në 7,6 milionë euro, ose rreth 26.7 për qind e eksporteve të përgjithshme, me një rënie prej (-9.9 përqindësh). Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në BE janë: Gjermania (6.2 për qind), Sllovenia (4.8 për qind), Holanda (4.6 për qind). Kurse, importet e Kosovës nga vendet e BE-së ishin rreth 126,6 milionë euro, ose 41 për qind e importeve të përgjithshme, me

një rritje prej 6.7 përqindësh. Importet me pjesëmarrje më të lartë ishin nga: Gjermania (11.6 për qind), Italia (7.2 për qind), Greqia (2.9 për qind), Polonia (2.6 për qind), Romania (2.3 për qind) etj", është theksuar në publikimin e ASK-së. Në muajin korrik 2018, eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s arritën në 16 milionë euro ose 55.7 për qind të eksporteve të përgjithshme, me një rënie prej -

24.2 përqindësh. Partnerë kryesorë për eksport nga vendet e CEFTA-s janë: Shqipëria (23.7 për qind), Maqedonia (12.7 për qind), Serbia (11.1 për qind), Mali i Zi (5.5 për qind).

Ndërsa importet nga vendet e CEFTA-s, në muajin korrik 2018 arritën në 82,3 milionë euro ose 26.7 për qind të importeve të përgjithshme, me një rritje prej 7.4 përqindësh. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin: Serbia (12.1 për qind), Shqipëria (7 për qind), Maqedonia (4.9 për qind) dhe B&H (2.1 për qind).

Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 5 milionë euro ose 17.6 për qind. Si partnerë më të rëndësishëm nga këto vende për eksport vlen të përmenden: Zvicra (8.4 për qind) dhe India (3.3 për qind). Ndërkaq, importet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 100 milionë euro ose 32.4 për qind. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin: Kina (10.5 për qind) dhe Turqia (9.9 për qind).

NJË IKJE E PLANIFIKUAR DHE MBASE E KOORDINUAR, BISHTIN E SHOHIM MË VONË!



Behxhet Sh. SHALA - BAJ-
GORA

Ferma e Orwelit dhe Luva e Kapixhikut: Prokurori i Prokurorisë Speciale, Elez Blakaj, pasi e paska dorëzuar një draftakuzë (sipas interpretimit të Prokurorisë Speciale) kundër atyre që lejuan fryrjen tejmasë të listës së veteranëve të luftës, humbi, u tretë si sh... e pulës për t'u lajmëruar nga Amerika duke kallëzuar për kërcënimet që ishin bërë ndaj tij, që nga veteranët hileqarë, nga anëtarët e komisionit, nga punëdhënësi i tij apo shefi e deri te kryetari i Koresë së Veriut, Putini, ai i Filipineve, i Hondurasit e kush jo tjetër. Me këtë e hapi Kutinë e Mihrisë (Pandorës) në Kosovë, duke ndarë në dy skaje krejtësisht të kundërta; nga ata që e konsideronin frikakakë dhe hajn, dezertor dhe matrapaz, joprofessionist dhe protagonist për ta luajtur rolin e luanit i mbështjell me lëkurë të hienës e deri tek ata, që një numër i tyre kishte dëgjuar për të vetëm pasi u lajmërua nga Amerika ku paska shkuar ta realizojë "ëndrën amerikane" dhe të cilët e konsideronin hero të vërtetë,

profesionist të jashtëzakonshëm, trim dhe guximtar, sfidues të dallaveraxhinje dhe epitete të tjera, të dëgjuara dhe të padëgjuara deri më tani. Kur po flitet për tash ish-prokurorin Elez Blakaj, më iku mendja te prokurorët dhe gjykatësit italianë që e paguan me jetë guximin dhe profesionalizmin e tyre në luftë kundër së keqes (mafisë italiane) dhe në shërbim të ligjit si dhe në mbrojtje të qytetarit për çka edhe kishin dhënë betimin. Mund të përmend vetëm disa emra që u bënë të njohur edhe në Kosovë me sakrificën e tyre, Xhovani Falkonen, Paolo Borselinon, Alberto dela Kiezan dhe shumë të tjerë që e sakrifkuan jetën e tyre si dhe të familjes, por që kontribuuan që t'i thyhen dhëmbët mafisë italiane dhe krimin të organizuar në Itali të cilin nuk e çrrënjosën krejt, por e shembën bukur shumë. Këta nuk kërkuan nga autoritetet italiane siguri të përjetshme, por kërkuan siguri për një kohë të caktuar, për aq kohë sa vlerësuan se mund t'i fusin pykat në trupin, deri atëherë virgjinë të mafisë italiane. Që të gjithë këta, së bashku edhe me anëtarë të familjeve të tyre, u ekzekutuan nga vrasës të paguar pas një kohe të caktuar mirëpo, as mafia nuk shpëtoi lehtë, shumë krerë të mafisë u arrestuan dhe u dënuan me dënime të larta dhe aty u promovua edhe roli i insajderit - pendestarit apo bashkëpunuesit me prokurorinë dhe gjykatën, që e dëmtoi pariparueshën organizimin, deri atëherë të përsosur të mafisë dhe e theu kyçjen e gjuhës të njohur si omerta apo Ligji i Heshtjes. Prokurorët dhe gjykatësit e vendosur dhe sakrifkues italianë dërguan prapa grilave shumë mafiozë të mafisë politike italiane, duke

përfshirë edhe ministra sikur që edhe kryeministrin Andreoti e detyruan të kërkojë azil politikë në një shtet afrikanë. E në Kosovë, si qëndron puna në këtë drejtim?! Pas përfundimit të luftës, luftimin e krimin të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë sikur edhe krimeve të luftës ishte kompetencë ekskluzivisht e ndërkombëtarëve të cilët edhe vetë u bënë pjesa më aktive dhe më përfituese e aktiviteteve kriminale duke i përdorur politikanët injorantë kosovarë vetëm si sekserë dhe hyzmeqarë, por të cilët shumë shpejt e mësuan dhe përvetësuan "shkathtësinë" e hajnisë nga mjeshtrit e zanatit, ndërkombëtarët grabitqarë që kishin mbaruar shkollën e hajnisë nëpër vendet që kishin dalë nga lufta dhe vatrat e tjera të krizës sikur në Kroaci, Bosnje dhe vendet e Afrikës apo Amerikës së Jugut. Sot keni ministra në Qeverinë e Kosovës që përparuan me një shpejtësi të jashtëzakonshme, nga sekseri deri te hajni dhe kriminelin i rryer, pasi përfunduan trajnimet në **n d ë r k o m b ë t a r ë t**. Ndërkombëtarët fillimisht në strukturat e hetuesisë, policisë, prokurorisë dhe gjyqësorit rekrutonin njerëz të dëshmuar dhe të dëgjueshëm apo yes - man dhe të cilët pastaj u miqësuan edhe me politikanët e vendit. Për dallim nga prokurorët dhe gjykatësit italianë të cilët vriteshin sikur që vriteshin anëtarët e familjes, hidhnin bomba mbi ta dhe vendosej eksploziv në veturat dhe shtëpitë e tyre, jua frikësonin dhe rrëmbenin fëmijët, por se nuk ligështoheshin para këtyre rreziqeve, prokurorët dhe gjykatësit kosovarë nuk përballëshin me këto rreziqe (për fat të mirë) dhe frikën e bartnin për së rëndi. Në një vend ku keni një strukturë të

organizuar kriminale e cila është e konsoliduar apo në konsolidim e sipër, prokurorët dhe gjykatësit, përveç profesionalizmit në këto fusha, duhet të jenë edhe të guximshëm duke pranuar riskun, si shok të pandashëm. Te ne kjo nuk ka qenë e theksuar sepse shkolla e tyre (nga ndërkombëtarët e korrupsuar) ju ka krijuar një alibi apo faturë për mosveprim. Unë nuk njoh një rast që dikush nga prokurorët apo gjykatësit janë kërcënuar apo rrezikuar në Kosovë në atë masë sa që "iu prishet ëndrra e një nate vere" e lëre më familjet e tyre. Në rrafshin material pagat i kanë më të lartat në rajon sikur që edhe janë të mbuluar nga shoqëruet për mbrojtje të afërt gjithmonë kur kanë kërkuar apo kur është vlerësuar se mund të jenë të rrezikuar. Natyrisht, është fakt se politika vendos për fatin e tyre, si në planin afirmativ ashtu edhe për pasojat eventuale në karrierat e tyre. E që nuk do të duhej të ishte kështu dhe që këtë nuk do të duhej ta pranonte asnjë prokuror apo gjykatës i ndërgjegjshëm, i përgjegjshëm, profesional dhe dinjitoz. Sot, falë mundësive të mëdha të rrjeteve sociale, gjithkush dhe askush mund të kërcënojë kënd të dojë, kurse prokurorët dhe gjykatësit, për shkak të natyrës së punës që e bëjnë, janë shumë atraktivë. Por kjo nuk nënkupton që, pas kërcënimit të parë, t'i lëshoni brekushet e pastaj të ankoheni që po jua fusin pavarësisht se konsideroheni i dorëzuar dhe në këtë situatë jeni të mbrojtur nga të gjitha konventat ndërkombëtare dhe ligjet kombëtare, si pengje apo që i keni lëshuar poshtë brekushet e bardha. Prokurori Elez Blakaj nuk ka treguar as vullnet e as guxim për ta mbrojtur pjellën (aktakuzën)

që vet e ka bërë por kjo nuk nënkupton se duhet të fyhet. Frika është njerëzore sidomos në një vend ku dhuna ka qenë meny e përditshme për të siguruar mbijetesën. Fizike dhe profesionale. Prokurori Blakaj ka vepruar si një prind i papërgjegjshëm i cili, fëmijën e porsalindur e mbështjellë me diçka dhe e lë në rrugë në mëshirë të ndonjë kalimtarit të rastit apo edhe të ndonjë grabitqari të rastit. Nuk mjafton ta dorëzosh aktakuzën kundër dallaveraxhinjeve që i frynë tejmase listat e veteranëve dhe pastaj t'ia mbathësh në një largësi të sigurt siç bëri Elez Blakaj. Kush e mbron aktakuzën e Elez Blakajt kur ai nuk e mbron vet?! Askush dhe asnjëri. Protestat e organizuara në "mbrojtje" të ish-prokurorit Blakaj ishin protesta kundër pushtetit aktual dhe për ta marrë pushtetin sikur që ishin shumica e të gjitha protestave. Me njerëz të njëjtë dhe kërkesa të njëjta. Protesta kundër politikës aktuale dhe në shërbim të një politike tjetër. Prandaj gjithmonë po dështojnë. Prokurori

Kosovës janë më të këqij se policët e Serbisë dhe shumë kush të tjera.

Ismail Kadare ka qenë i përkëdheluri i Enver Hoxhës duke i gëzuar të gjitha privilegjet e kohës dhe të cilat nuk i kishin as 99.99% e shqiptarëve sikur as 98% e shkrimtarëve të Shqipërisë. Madje kishte mundësi të punësonte kë të donte dhe për mua ishte zhgënjyes fakti kur një kolos i kulturës, letërsisë dhe disidencës kundër diktaturës në Shqipëri, gjeniu Lasgush Poradeci kërkonte ndihmën e pinjollit të Enver Hoxhës, Ismail Kadaresë për punësimin e vajzës së tij. Po ky Ismail Kadare, pasi e "mbijeto" diktaturën, u ndje i kërcënuar nga demokracia e brishtë shqiptare, pikërisht sikur Elez Blakaj, prandaj iku për Francë ku, brenda një kohe rekorde u pajis me pasaportë franceze, lejeidentifikimi dhe patentshoferi. Shteti francez kishte interes nga Kadareja kurse Kadare, si "disident" i demokracisë shpresonte ta merrte Çmimin Nobel për letërsi të cilin nuk e mori deri më sot. Llogaria për Çmimin Nobel për Letërsi ishte e projektuar mirë për faktin se thuaja të gjithë nobelistët për letërsi nga shtetet e lindjes apo shteteve diktatoriale këtë çmim e fituan, më shumë në saje të qëndrimit disident - kundërshtues ndaj diktaturës se kualitetit si shkrimtar. A do të përsëritet kjo histori edhe me ish-prokurorin Elez Blakaj?! Ta shohim.

Urrejta ndaj UÇK-së, trashëgimi gjenetike e dikur qenve e tash këlyshëve jugosllavë dhe serbë: Nuk ka ushtri që ka bërë luftë më të lavdishme se që e ka bërë Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe nuk ka ushtri që ka bërë luftë më të pabarabartë se që e ka bërë UÇK-ja. Në atë kohë, vetëm nëse të ka shkuar mendja ta kundërshtosh Jugosllavinë qoftë edhe në mënyrë paqësore, të kanë llogaritur të çmendur kurse kundërshtimin e armatosur nuk e kanë llogaritur as si imagjinatë. Nëse jeni arrestuar apo dënuar për shkaqe politike të kanë etiketuar me cilësimet më të ulëta si pleh i Kosovës apo minj të vrimave. Familjen ta kanë veçuar duke bërë përpjekje ta shkatërojnë moralisht dhe materialisht. Kush e kanë bërë këtë? E kanë bërë paraardhësit biologjikë të atyre që aq shumë e urrejnë sot UÇK-në dhe të cilën e identifikojnë me një grusht grabitqarësh dhe hajdutësh të shndërruar në kriminelë ordinere. Për pjellën e trashëgimitë titiste, rankoviqiste dhe mendësinë jugosllave dhe serbe një ushtarë i UÇK-së është i mirë dhe patriot vetëm nëse qenka vrarë gjatë luftës. Të vrarët janë të mirë, të gjallët janë kriminelë apo siç e thonë shpesh, sidomos kohëve

të fundit, janë më të zinj dhe më të këqij se shkiqet dhe se UÇK-ja ka bërë më shumë të këqija popullit shqiptar në Kosovë se vet Serbia. I nënshtruar gjithmonë mbetet i nënshtruar, i robëruar mbetet rob i nënshtrimit dhe këtë veti e trashëgon përmes kodit gjenetik. Në kohë të vështira këta maskarenj dhe krushq të robërisë, palosen dhe, me rastin e parë rebelohen dhe trimërohen sidomos kur marrin infuzione nga padronët e tyre. Për këta komandant legjendar Adem Jashari është i mirë vetëm se është i vrarë sepse, po të ishte gjallë do të bëhej si të tjerët. Këta nuk kanë komb, nuk kanë fe, nuk kanë atdhe, nuk kanë kurriz dhe nuk kanë moral dhe fytyrë. Me luftën e lavdishme të UÇK-së shqiptarët për herë të parë luftuan për veten e tyre. Këta, të lavdishmit ushtarë të së lavdishmes UÇK-së e çliruan Kosovën dhe jo NATO. NATO-ja e ndihmoi luftën por lufta e lavdishme, qëndresa shekullore dhe viktimizimi biblik ishte vendimtar për çlirim. Amerikanët janë miq por nuk ishin ata që e çliruan Kosovën. E ndihmuan çlirimin e Kosovës. Pse nuk e çliruan Kosovën në vitin 1945, 1968, 1975, 1981, 1989, 1997, 1998 por ndihmuan vetëm pasi shpërtheu lufta. Ishte e ashtuquajtura rezistencë paqësore për 10 vite dhe nuk pati asnjë intervenim apo ndërhyrje dhe, po të mos ishte lufta çlirimtare, ashtu siç ishte edhe sot Jovica Stanishiqi do të pinte shlivovicë me Fatonin në Mrezovicë. Edhe sot Nazemi do ta masakronte flamurin kombëtar për të hyrë në brekë të Millosheviqit. Edhe sot Jetoni do të shkonte ambasador i Serbisë dhe Jugosllavisë diku në botë. Edhe sot Çkelzeni do të ishte spiun i Jugosllavisë dhe Serbisë. Edhe sot do të vazhdonte vëllazërim - bashkimi midis serbëve që flisnin serbisht dhe serbëve që flisnin shqip kurse burgjet do të mbusheshin me shqiptarë që mendonin, vepronin, flisnin, jetonin dhe vdisnin shqip. Edhe sot do ta kishin idol dhe hero Ali Shukrinë, Kolë Shirokën, Sinan Hasanin, Fadil Hoxhën, Rrahman Morinën, Mehmet Maliq - Qorrin, birin e Dragqit, Jovica Stanishiqin kurse do të mbanin në burg Adem Demaçin dhe patriotët e tjerë. Këta sot e shajnë UÇK-në sepse ju ka ardhur koha e mirëdita - dobardanit si dhe janë ngjallur fantazmat e Vidovdanit. Ata që luftuan dhe e patën përnjëmend për lirinë e Kosovës nuk e bënë këtë për një vërtetim apo përfitim simbolik sepse investuan më shumë se çdo pasuri - jetën e tyre kurse këta që përfituan pamëritueshëm ishin kundërshtarë të luftës, bashkëpunëtorë të Serbisë, pjesëtarë të ministrive dhe ushtrive fantome që, edhe në

atë kohë zhvatnin parat e mërgimtarëve dhe kontributdhënësve të brendshëm. Është e vërtetë se edhe një pjesë e kriminalizuar e luftës u pasuruan shumë pas përfundimit të luftës por pse nuk flitet për hajdutët politikë të rezistencës paqësore para luftës. Hajni është hajn dhe nuk dallon nëse është i luftës apo i paqes sikur që nuk dallojnë as kriminelët. Nuk ka kriminelë të luftës dhe kriminelë paqësorë. Urrejta aq e madhe ndaj luftës së lavdishme të UÇK-së nuk është se komandantët paskan vjedhur por se e kanë kulturë të trashëguar nga paraardhësit e tyre biologjikë. Këta janë palosur vetëm kur janë frikësuar, tash janë trimëruar dhe shndërruar në patriotë... të leshit. Luftëtari dhe trimi gjithmonë mbeten të tillë, qyqari dhe tradhtari gjithashtu gjithmonë mbeten të tillë. Ky është realiteti sot në Kosovë. Heronjtë e Kosovës nuk kanë luftuar për ta mbrojtur pragun e shtëpisë por për t'u çliruar dhe për t'u bashkuar me Shqipërinë. Ai që e mbron pragun e shtëpisë nuk ka nevojë të vesh uniformën ushtarake dhe të formojë formacione ushtarake. Nuk ka nevojë të pajiset me zola, gulinovë dhe armatim të rëndë. Nuk ka nevojë të hapë istikame dhe të shtrijë vija të gjata të frontit ku bëhet lufta. Është e vërtetë se luftën në Kosovë nuk e kanë bërë gjeneralët apo profesionistët ushtarakë sepse, përjashtuar një numri të vogël, shumica e tyre e kanë sabotuar luftën. Nuk janë rreshtuar në UÇK-së. Një numër i oficerëve shqiptarë të ish Ushtrisë Popullore të Jugosllavisë e që kanë qenë atdhetarë kanë luftuar dhe kanë vdekur duke kaluar në përjetësi nën siglën e UÇK-së. Nuk iu ka penguar aspak UÇK. Ndërsa, ish bashkëpunëtorët e Jugosllavisë dhe të Serbisë e që kanë vdekur si të tillë, kanë dezertuar nga lufta duke iu dorëzuar armët ushtrisë, policisë dhe paramilitarëve të Serbisë sikur që ua kanë dorëzuar ushtarët e plagosur të UÇK-së. Të tillët sot janë veteranë të UÇK-së dhe për turpin e historisë, edhe heronjë të Kosovës. Kjo tregon më së mirë skemën e veteranëve të rrëshëm dhe heronjve të shpifur. Adem Jashari nuk ka pasur nevojë të jetë gjeneral. As Zahir Pajaziti, Edmond Hoxha, Rexhep Mala, Hakif Zejnullahu, Fahri dhe Bahri Fazliu, Xhevë Krasniqi dhe Fehmi Lladrovci dhe shumë heronj të tjerë. Ata e kryen detyrimin ndaj kombit dhe atdheut sikur që mohuesit e UÇK-së e kryen dhe po e kryejnë detyrimin ndaj Jugosllavisë dhe Serbisë. Është çështje bindjeje dhe përcaktimi. Është hapur një debat idiotesk se kur qenka ditëlindja e komandantit legjendar Adem Jashari. Nuk kam dëgjuar kohëve të fundit diçka më të shëmtuar se ky debat. Heronjtë e kombit që kanë rënë

për atdhe janë të përjetshëm dhe nuk ka fare rëndësi kur kanë lindur sepse edhe kjo botë sikur edhe amshimi është i tyre, historia dhe nderi u takon atyre, kujtimi dhe ardhmëria ndërtohet mbi luftën dhe sakrificën e tyre. Ne jemi të vdekshëm dhe na mbulon pluhuri i harresës kurse heronjtë janë të pavdekshëm. Kështu veprohet në çdo vend normal të botës! A është Kosova një vend normal?! Nuk e di, nuk jam i sigurt se është.

Treshi përsheshi: Sot njerëzit më të rrezikshëm dhe më të këqij në Kosovë dhe për Kosovën janë Hashimi, Begjeti dhe Batoni. Nëse Hashimit nuk mund t'i mohohet e kaluara kombëtare dhe sakrifikuese, për dy të tjerët nuk mund ta gjeni as në gjurmë një të kaluar të tillë. Se çka i lidhë këta tre persona në këtë kohë, edhe budallenjtë e kanë të qartë, interesi dhe vetëm interesi. Më bënë përsheshje se më lehtë flet Hashimi për ndryshimin e kufijve me Serbinë e të cilin e maskon me korrigim të kufijve se dikush që e pinë një makiato të mëngjesit. Kush leshi është Batoni të thotë se duhet t'i jepet Serbisë veriu i Kosovës për të mos fituar asgjë apo për ta fituar Nobelin Hashimi dhe Vuçiqi apo për t'i shpëtuar prapanicat e rrezikuara. Me çfarë të drejte dhe ku e ka fituar të drejtën Gjet Colli të flasë në emër timin që, së paku kam bërë më shumë se 8 vite burg politik kur ai i ka flladitur top... në vendet e lindjes ku perëndon dielli i lirisë. Këta tre të mjerë po shkojnë drejt fundit dhe duket se kanë vendosur mos të jetojnë në Kosovë sepse atdheu i tyre nuk është Kosova. Së paku nuk e llogarisin si të tillë kur aq pa mëshirë duan ta bëjnë rrush dhe kumbulla. Shpresoj se nuk do ta arrijnë ta bëjnë këtë sepse në skenë po del një ushtri e re me komandantët Lumir, Driton, Haxhi, Bajram, komandanten shoqen Vjosë dhe shoqen Mimoze, komisararin Ilir dhe shumë ushtarë dhe ushtarë të tjera që fort janë mërdhezur... duke e sulmuar UÇK-në, në fakt po e mbrojnë treshin famëkeq dhe fatkeq! Qofsha i gabuar!

Matoshi premton përkrahje për mjedisin në Komunën e Gjakovës

PRISHTINË, 24 GUSHT (ER) - Ushtruesi i detyrës së ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, ka pritur të premten në takim kryetarin e Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, me të cilin ka biseduar në lidhje me bashkëpunimin për realizimin e projekteve në fushën e mjedisit dhe planifikimit hapësinor. Gjatë takimit ministri Matoshi u njoftua nga kryetari Gjini lidhur me ecurinë e punimeve për rregullimin e shtratit të Lumit "Krena", projekt ky që po financohet nga MMPH-ja, kurse Matoshi ka përsëritur gatishmërinë e tij që ta përkrahë Komunën e Gjakovës edhe me projekte të tjera në të ardhmen për ta përmirësuar gjendjen e

mjedisit në këtë komunë. Në cilësinë e udhëheqësit të Task Forcës për aksionin "Ta pastrojmë Kosovën", ministri Matoshi ka kërkuar nga kryetari Gjini angazhimin e përbashkët me Komunën e Gjakovës në aksionin tremujor për pastrimin e Kosovës. Ndërsa kryetari Gjini, pasi ka falënderuar ministrin Matoshi për përkrahjen dhe projektet që MMPH-ja po realizon në Gjakovë, u zotua se do të angazhohet maksimalisht në fushatën tremujore për pastrimin e Kosovës si dhe do të bashkëpunojë ngushtë me ministrinë për realizimin e projekteve në fushën e menaxhimit të mbeturinave, lumenjve, burimeve ujore, urbanizëm e planifikim hapësinor.



Gjilani mban debat për fuqizimin e rinisë

GJILAN, 24 GUSHT (ER) - Në kuadër të Muajit të Rinisë në Gjilan është mbajtur një debat me temën "Fuqizimi i rinisë me ndryshim plotësimin e Ligjit për rini", ku kanë marrë pjesë përfaqësues të shoqërisë civile, të organizatave rinore, vullnetarët rinorë dhe drejtori i rinisë në MKRS, Xhevat Bajrami. Genc Mustafa, koordinator për rini në kuadër të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ka thënë se ky debat është tejet i rëndësishëm me qëllimin më të mirë që propozimet e përfaqësuesve të OJQ-ve të ndikojnë që ky ligj të bëhet sa më i mirë. "Jemi komuna e parë që




kemi mbajtur debat me shoqërinë civile, organizatat rinore dhe vullnetarët rinorë. E falënderoj për praninë e tij drejtorin e rinisë në MKRS, Xhevat Bajrami. Në këtë rast dua ta falënderoj edhe kryetarin Haziri për mbështetjen që po i jep rinisë gjilanasë në vazhdimësi", ka thënë Mustafa.

F t e s ë

Me 26 gusht 2018, ditë e diele, në Aqarevë të Drenicës, ju ftojme të merrni pjesë në përvjetorin e 20 - të, për Dëshmorin, njërin nderë themeluesit dhe Usharakun e UÇK-së Ismet H. Rrahmani 1962-1998, për njëriun me ndikim që kishte, shkolla shqipe dhe lufta për liri. Përveç homazheve të varrit të tij, manifestimi qëndror do të mbahet të Kulla e ndërtuar mbi gjakun e tij, në ora 12:00, aty ku ra për të mos vdekur kurrë.

Këshilli organizativ: tri shoqatat e UÇK-së, dega në Skenderaj, së bashku me familjen.

Ardhja e juaj nderon gjakun e Ismetit!



Nesër përkujtohet dëshmori Ismet Rrahmani

Skenderaj, 24 gusht - Nesër (e diel) në fshatin Aqarevë të Skenderajt do të përkujtohet, në 20-vjetorin e rënies, dëshmori Ismet Rrahmani. Manifestimi qëndror do të mbahet në orën 12:00 te kulla e dëshmorit Ismet Rrahmani.

Komuna mbështet idenë për aftësimin profesional të femrave

Mitrovicë, 24 gusht (ER) - Nën kryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, dhe drejtori i Drejtorisë për Financa, Shukri Gashi, kanë biseduar me përfaqësuesen e "UNI BB", Sh.p.k., Flutura Dedinja, disenjatore e modës, për mundësinë e realizimit të një projekti për ofrimin e shërbimeve profesionale, kurse për rrobaqepësi. Duke folur për projektin, Dedinja ka treguar për përvoja tashmë të realizuara në komuna të tjera, ku janë realizuar projekte të këtylla

me shumë sukses. Ajo ka thënë se oferta parasheh që në Mitrovicë të organizohet një kurs i tillë, në të cilin do të përfshiheshin prej 15 deri 20 femra, të moshave të ndryshme. Sipas saj, kursi do të zgjasë gjashtë muaj dhe për realizimin e tij kërkohet edhe mbështetja materiale e komunës, si dhe sigurimi i një hapësire të mjaftueshme për mbajtjen e ligjëratave. "Në bazë të përvojave të deritashme, mund të them se kandidatet që kanë përfunduar

këtë kurs, e të cilat në përfundim të tij certifikohen, kanë pas sukses në punësim të menjëherëshëm. Besoj se kjo do të ndodhë edhe me kandidatet e Mitrovicës", ka thënë Dedinja. Nën kryetari i Komunës, Faruk Mujka, dhe drejtori për Financa, Shukri Gashi, kanë theksuar se ideja është e mirë dhe e qëlluar, dhe premtuan se komuna do ta shqyrtojë gjithanshëm ofertën dhe mundësitë e saj në mënyrë që të sigurohen mjetet dhe hapësira.



Bekim Jashari takon drejtorët e shkollave para fillimit të vitit të ri shkollor



SKENDERAJ, 24 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka takuar të premten drejtorët e shkollave në këtë komunë, me të cilët ka diskutuar për punën që po bëhet rreth përgatitjeve për fillim të vitit të ri shkollor 2018/2019. "U informova se drejtorët e shkollave në përgjithësi kanë përfunduar të gjitha përgatitjet, ndërkaq shkollat që janë në udhëheqje të tyre janë të gatshme për t'i pritur nxënësit në kuadër të

vitit të ri shkollor 2018/2019", ka thënë Jashari. Ai ka siguruar të gjithë drejtorët, pa përjashtim, se do ta kenë mbështetjen e tij, edhe jashtë orarit zyrtar të punës, madje edhe në ditë pushimi, në funksion të rritjes së cilësisë në arsim. "U kërkova ta shtojnë angazhimin në procesin e mësimdhënies, si dhe pastërti në ambientet shkollore", ka thënë Bekim Jashari, kryetar i Komunës së Skenderajt.

Ç'kemi në këto 'lule'?

(Rrustem Berisha, "Lulet e pleqërisë", Artini, Prishtinë, 2018)



Sadri FETIU

Kur i lexova vjershat e përmbledhjes "Guri i Gjeranës" të Rrustem Berishës e vërejtja fare mirë se ky autor i është kthyer me shpirt dashurisë së tij të parë, poezisë, të cilën e kishte lënë në harresë gati për 30 vjet. I përjetova me kënaqësi këto vjersha dhe u binda se këtu ishin shumë nga veçantitë poetike, të cilat janë të pranishme edhe në vjershat e tij të para, që i kam lexuar dikur në moshën e rinisë. Pak më vonë, përjetimet e njëjta i pata edhe duke lexuar edhe poezinë e veprës pasuese të këtij poeti, "Kroni i lajthisë", të cilën e përshkruajnë shumë pamje të përjetuara dhe të rikrijuara me një ndjeshmëri të rrallë nga periudha e fëmijërisë. E ndjeva si të ishte edhe pjesë e jetës sime aromën e vendlindjes së tij të strukturuar me një varg formalisht klasik, por kuptimisht modern në shumicën e cikleve të kësaj përmbledhjeje.

Duke përfunduar recensionin për këtë vepër e krijova bindjen se Rrustem Berisha ka çka për të na thënë edhe më tutje, dhe do të vazhdojë të krijojë poezi të reja, prandaj edhe pohova se do të ishte mirë, që në këtë frymë ta realizonte edhe një përmbledhje të tretë. Bindja ime doli e vërtetë dhe ai tash, brenda një kohe relativisht të shkurtër nga botimi i përmbledhjes së mëparshme, po i ofron lexuesit një vepër të re poetike, e cila mund të zgjojë interesim, duke filluar që nga vetë simbolika e titullit - "Lulet e pleqërisë".

Pa hyrë fare në analiza të veçanta të vlerave poetike të këtij libri, kësaj radhe do të tregoj shkurtimisht se çka kemi në këtë përmbledhje.

Libri hapet me një tekst të shkurtër - porosi e poetit për lexuesit e librit të tij, ku ai kërkon që ata të kenë parasysh se këto vargje i ka hartuar një tetëdhjetëvjeçar, i cili ka dëshirë që edhe lexuesit të gjykojnë dhe të ndjejnë njësoj si ai. Po këtu është edhe një strofë që shpreh vetëdijen e autorit për vlerat e poezisë, në të cilën tregohet modestia e poetit të moshuar, që i ka krijuar këto "lule të pleqërisë".

Vjershat e ciklit të parë "Në oborr të Fishtës" i përshkon fryma e atdhedashurisë së poetit, që në fillim krijon një

paralele të bukur historike dhe aktuale ndërmjet dy kalave të qyteteve të lashta shqiptare, Prizrenit dhe Ulqinit, vargje këto ku përvijohet krenaria dhe dhembja shekullore që poeti e ndjen në shpirtin e tij sa herë që udhëton nga një qytet në tjetrin. Duke përjetuar aktualitetin e kohës sonë ai në vizionin e tij poetik e përjeton edhe shërimin simbolik të plagëve të Gjergj Elez Alisë, ndërsa duke e përsiatur për kultin e poezisë ai atë e konsideron si me shpatë me të cilën e pret tiraninë.

Ndjeshmëri atdhetare autori përjeton bashkë madhështinë e poezisë së Gjergj Fishtës në vjershën kushtuar oborrit të poetit tonë të madh kombëtar, por edhe dhembjen për pakujdesinë e tanishme ndaj trashëgimisë kulturore. Ndjenja e dashurisë ndaj atdheut përjetohet fuqishëm edhe në vargjet e vjershës "Lumturisht", pastaj "Lule e luleve", ndërsa dhembja dëbimin e dhunshëm nga atdheu shprehet më së mirë në vargjet e vjershës "U bëra refugjat".

Në vazhdim ciklit i ri i vjershave titullohet "Lisi i madh", ku krahas evokimit të kujtimeve të shumta nëpërmjet personifikimit të këtij lisi të vendlindjes shprehet dashuria dhe dhembja për fatet e njerëzve të vendlindjes së tij, lisi i madh i të cilës është bërë simbol i qendrës, i paralajmërimeve të rreziqeve, i përrurimit të lindjeve dhe i shpalljes së vdekjeve të njerëzve të këtij mjedisi. Brenda këtij ciklit kemi edhe disa vjersha të ndjeshme me tematikë sociale, në të cilat e përgjithshmja dhe e veçanta gërshetohen brenda shprehjes realiste, ku bëhen edhe paralelizma të largëta me "të mjerët" e Viktor Ygos, por edhe përshkruhet në hollësi sjelljet e evgjitit, gishtat dhe dora e lypësit, si edhe shprehet papunësia e madhe e njerëzve që edhe sot e kësaj dite kërkojnë punë me anë të konkurseve, por nuk kanë mundësi të jetojnë me nderë nga puna e tyre. Vjen pastaj edhe pyetja retorike "kush na nxjerr nga humnera", "si të dalim nga skëterra", si edhe pasojat e trashëguara të hakmarrjes, vëllavrasjeve e inateve të shumta që e përdhosin shpirtin e njeriut.

Në vazhdim e kemi ciklit me titull "Poezitë e mia me ju", ku poeti i personalizuar komunikon drejtpërdrejt me lexuesin për preokupimet e tij jetësore, për jetën që e ka fillimin, por edhe kapakun e vet. Është këtu edhe poezia reflek-

sive për Vitin e Ri, numrat e të cilit ikin bashkë me vrapimet dhe nuk kthehen më kurrë. Në një nga vjershat e këtij ciklit tërhiqet një paralele poetike interesante midis zogut shtegtar dhe poetit, kur të dy udhëtojnë, zogu me krahë të vërtetë dhe poeti me fantazi, poeti duke u struktur në vetminë e vetë, kurse zogu i lirë ngjitet në lartësi me shumë cicërima e me këngë. Po këtu kemi edhe kontrastin midis lotit dhe gjakut si dy simbole të ndjeshmërisë dhe të dhembjes që e masin peshën duke bërë krahasime midis llojeve të lotëve, më ç' rast peshën më të madhe e ka loti i nënës që mbyl krejt në pikëllim, i manifestuar nga dhembja për fëmijët e saj, Brenda kësaj poezie reflektive kemi edhe situata të tjera konstantive, në të cilat poeti e paraqet edhe zërin tjetër, ku vargjet janë në vazhdimësi "lavd dhe vaj" dhe gjithnjë "kushtrim për më të mirët". Ai pohon se nëpërmjet poezisë ecet gjithnjë "në rrugën e fantazisë" dhe nga ajo dëgjohen "vetëm zërat e dashurisë". Duke komunikuar drejtpërdrejt me lexuesin e vet poeti tregon pse shkruan poezi, duke pasur gjithnjë dyshimin se si do të pranohet ajo nga ata që e lexojnë, sado që në momente frymëzimi është i vetëdijshëm se kjo nuk është një punë e kotë. Duke konstatuar se vjershat e tij janë "lule të pleqërisë", ai e tërheq një paralele ndërmjet plakut dhe fëmijës, ku pleqtë janë "në kolonën e lodhur të ngjarjeve që kanë ndodhur", kurse fëmijët janë të shumtë dhe e "kanë mbushur oborrin". Në radhën e kësaj poezie kemi edhe plotë parandjenja për bregat e vogla, për udhëtimin simbolik, për shikimin gjithnjë e më të mjegullt, por edhe për respektin që plaku gëzon nga të rinjtë, bashkë me dëshirën që të shtyhen vitet e jetës, të ketë sa më pak ndodhi të trishtueshme, sa më pak stuhi në të cilat plaku nuk do ta njohë as vetveten. Kemi këtu edhe plot rrëfime të çiltra për moshën, për gjendjen fizike e shpirtërore të pleqve e në ndonjë rast këtë e ilustron edhe përshkrimi i ndjeshëm deri në dhembshuri e përgjërimit për "plakun e krejt mëhallëve" që tashmë ka mbetur krejt i vetmuar.

Këtu është edhe një cikël i poezive të ashpra, ku zemërimi i poetit është i papërmbajtur, ku ai i godet si me çekan të gjithë ata që e kanë katranosur gjendjen e përgjithshme të shumicës së popullit të Kosovës. Pra, vjershat për "Katranxhinjtë" fillojnë me një

ironi të hollë për "ditën e mirë" - pa ligje, të cilat i kanë miraturar "ata që e kanë prishur grigjën" Realiteti i vrazhdë i Kosovës së sotme, sipas poetit, mund të tregohet vetëm nëpërmjet gojës së "të marrit të rrugës", që nuk kursehet që nuk ngurron edhe ta shajë pushtetin e korruptuar deri në palcë. Në këtë cikël janë pastaj një numër poezisë sarkastike që janë kuptimplote edhe si tituj: "Çartavendi", "Historia e qenve", "Hendeku i madh", "Fytyrëmajmuni" "Gojëujku", "Gjuha zero", "Katranxhinjtë" etj. Në to shfryhet një mllef i madh i njeriut të pakënaqur, të mos them të mllefosur dhe të zhgënjyer keq, me të gjitha të këqijat që i kanë ndodhur këtij vendi. Në ndonjë rast gjuha e poetit është krejt retorike, por këtu ka edhe shprehje të reja simbolike dhe figura të rralla interesante, të cilat e pasurojnë poezinë tonë satirike në përgjithësi.

Në ciklin vijues që titullohet "Valët e verës" poeti i kthehet përsëri poezisë së qetë që lidhet me kujtimet e së kaluarës, ku ai sikur e poetizon me fantazinë e tij një urë të padukshme lidhëse ndërmjet dy periudhave të rëndësishme të moshës - fëmijërisë dhe pleqërisë. Me ndjeshmërinë e një plaku të përmalluar e të mallëngjyer nga kujtimet e fëmijërisë ai në poezinë e tij sjellë në një varg pamjesh formale dhe në rikrijime të ndjeshme situata nga e kaluara, nga fëmijëria e tij në vendlindje, të cilat me një fantazi të tejdukshme i lidh ato me vende krejtësisht të largëta, në mënyrë të veçantë me fshatin Shtoj afër Ulqinit, në të cilin poeti ynë e ka kaluar një pjesë të jetës së tij, sidomos gjatë pushimeve në stinën e pranverës dhe të verës. Të arriera artistikisht, sa mund të quhen lirisht me vlerë antologjike, në këtë cikël janë sidomos vjershat: "Bajrami i Madh", "Valët e verës", "Këtu e ndjej veten mirë" etj. Këto vjersha dhe përgjithësisht poezitë e këtij ciklit i përshkon një ngrohtësi e veçantë e përmallimit për të kaluarën, një ndjeshmëri e përjetimeve të sotme bashkë me gërshetimin e një rrezatimi kuptimplotë ndërmjet periudhave ekstreme të jetës - fëmijërisë dhe pleqërisë, të cilat edhe si të tilla përmbajnë inde të shumta poetike që autori i ka realizuar me një mjeshtri të veçantë.

Ritmet e ndjeshmërisë së periudhës rinore në vetëdijen e poetit të moshuar e karakterizojnë edhe ciklin e titulluar "Valletarja". Midis këtyre vjershave janë realizuar artistikisht

motivet e veçanta në vjershat: "Një shteg i kujtimeve", "Drithma shqetësimi", "Valë cicërimesh" dhe "Valletarja". Edhe në këto vjersha është gërshetuar bukur bota e ideve dhe e ndjenjave të realitetit të sotëm me shprehjen tradicionale të poezisë sonë.

Përjetimet intime të poetit në përditshmërinë e tij jetësore, brenda rrethit familjar dhe shoqëror e përshkruajnë edhe ciklin e vjershave "Bregë e vogël", ku gjejmë shumë hollësi, të cilat mund t'i vërejë vetëm syri i poetit dhe çështje që e karakterizojnë botën e tij të krijuar brenda atyre mjedisve. Për një frymëmarrje poetike të ngjashme me atë të Dritëro Agollit, këtu brenda mikrobotës së poetit, i gjejmë disa poezi, midis të cilave për vlerën e veçantë poetike shquhen poezitë "I miri qen, Larko" dhe ajo me titull "Pak në oborr".

Përmbledhja poetike "Lulet e pleqërisë" e Rrustem Berishës përmban edhe një cikël vjershash përshkruese me titull "Fytyrë dimri". Edhe në këtë rast përshkrimi është në funksion të përjetimeve të moshës dhe të përshkrimeve poetike të mjedisve të caktuara, që kanë edhe kuptime simbolike, si, bie fjala "Deti fëmijë - deti Perëndi". "Me pranverën ngohu vetin", "Turbullirë kohe" dhe "Në fund të udhëtimit".

Poeti Rrustem Berisha, që në rini është shquar si krijues i letërsisë për fëmijë, veçanërisht i prozës, edhe këtë përmbledhje e mbyll me një cikël vjersha për më të rinjtë, që e ka titulluar "Eja flutur". Me anë të këtyre vjershave poeti komunikon natyrshëm me fëmijët, duke paraqitur poetikisht situata të ndryshme nga jeta e fëmijëve dhe duke treguar ndonjë episod nga fëmijëria e tij. Këto vjersha i karakterizon gjuha e pasur dhe ritmika e veçantë e poezisë së fëmijëve.

Në fund do të theksojmë se përmbledhja "Lulet e pleqërisë" e Rrustem Berishës përmban në vetvete shumë poezi të bukura si përjetime të një poeti të moshuar, i cili e ka ende të gjallë dhe të fortë muzën poetike: frymëzimin, fantazinë, përjetimet e fuqishme dhe fuqinë shprehëse të fjalës poetike. Ai do të ecë edhe më tutje bashkë me poezinë, të cilës i është përkushtuar tërësisht, si në moshën e rinisë, ashtu edhe tash kur e ka përfunduar përmbledhjen "Lulet e pleqërisë". Nuk do të ishte aspak e habitshme nëse ai edhe në të ardhmen do të na dhuronte edhe ndonjë përmbledhje të re poetike...

E rrallë

Vonesat e ambulancave, shqetësuese në Britani

Shifrat e Lirisë së Informacionit kanë zbuluar vonesat më të gjata të ambulancave në Mbretërinë e Bashkuar. Një pacient në Uells ishte lënë duke pritur

për 62 orë, ndërsa katër të tjerë kanë pritur 50 orë, tregojnë të dhënat e Lirisë së Informacionit. Disa prej tyre që pritnin më shumë se një ditë për të arritur një



ambulancë ishin duke vuajtur nga probleme të shëndetit mendor ose të frymëmarrjes.

FOTO E DITES



Anëtarët e Marinës Indoneziane marrin pjesë në ceremoninë e ngritjes së flamurit për nder të 73-vjetorit të pavarësisë së vendit të tyre. /AP/

E jashtëzakonshme

Pasi shpenzuan 40 mijë dollarë, lindën një fëmijë

Një çift ka ndarë fotografi të vajzës së tyre të porsalindur, të rrethuar nga 1.616 gjilpëra që i përdoren në betejën e fertilitetit. Patricia dhe Kimberly O'Neillit, iu deshën plot katër vjet, tri dëshitime dhe 1 616 shkrepte të fotos për të pasur një foshnjë me imazhin i cili është bërë simbol i shpresës. Patricia dhe Kimberly O'Neill u përballën me shpërthimin e



zemërimit pasi shpenzuan 40 000 dollarë për të lindur një fëmijë.




DASHI
Personat pranë jush janë disi të

bezdisur nga sjellja juaj kohët e fundit. Do të preferonin t'ju shihnin siç keni qenë gjithmonë.



DEMI
Në të ardhmen nuk keni pse fshiheni pas

premtimeve boshe që ju kanë bërë. Është mirë të filloni ta krijoni pavarësinë tuaj dhe t'i ridimensiononi marrëdhëniet.



BINJAKËT
Megjithëse jeni përpjekur me mish e me

shpirt të përfundoni një projekt të caktuar, kushtet dhe rrethanat nuk ju kanë lejuar këtë gjë.



GAFORRJA
Lejojini një personi t'ju japë

zgjdhjet e veta sot. Me pak mbështetje mund të bëhet aleati më i mirë i juaj në të ardhmen.



LUANI
Aktivitetet që keni për sot mos i shtyni

për një afat të pacaktuar. Shumë gjëra do të jenë në varësi të situatave të krijuara ditën e sotme.



VIRGJËRËSHA
Nuk keni një gjykim të drejtë mbi

situata dhe persona të caktuar. Prisi të jeni të sigurt përpara se ta shprehni opinionin tuaj.



PESHORJA
Do të ndikoheni nga persona që do

t'ua ndryshojnë totalisht këndvështrimin e gjërave. Jeni bërë fleksibël kohët e fundit.



AKREPI
Sot duhet ta lini mënjani kre-narinë tuaj

dhe të bëni ç'është e mundur për të finalizuar një projekt të përbashkët. Do të shpërbleheni për mundin.



SHIGJETARI
Çdo gjë që keni zgjedhur të bëni sot

do të përkojë me planet tuaja për të ardhmen. Jeni më të qetë kur bëni një planifikim paraprak.



BRICJAPI
Shumë njerëz mësojnë nga gabimet

e tyre dhe e njëjta gjë do t'ju ndodhë edhe juve. Përvoja ju ka bërë më të ftohtë në marrëdhënie.



UJORI
Keni bërë zgjedhje të rëndësishme dhe

sot nuk mund të ktheheni pas edhe nëse do të dëshironit. Pak më fleksibël në raport me partnerin sot.



PESHQIT
Po vini në pikëpyetje të gjitha

gjërat që një person i afërt ka bërë për ju. Shumë shpejt do ta kuptoni që keni gabuar në disa raste.

BARSOLETA E DITËS



Shkon një biondinë në shitore dhe blen një pako qumësht. Duke dalë te dera, kthehet dhe i thotë shitësit: - Pse po shkruan në pako 'hape këtu'? A nuk bën ta hap në shtëpi?



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit në ora 16:00

“ INCREDIBLES 2” 3D
I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

Rolet: Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

Regjia: Brad Bird



Në ora 18:20

“FUTURE WORLD”
I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 41 min

Rolet: James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

Regjia: James Franco



Në ora 20:00

“ANT-MAN AND THE WASP” 3D
Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 ore 58 min

Rolet: Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

Regjia: Peyton Reed



Në ora 22:00

“LOVING PABLO” (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 min

Rolet: Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

Regjia: Fernando León de Aranoa



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

SANTOS - BAHIA

1

JUVENTUS - LAZIO

3+

AMIENS - REIMS

1

Llapi për këndellje ndaj Ballkanit

KF Llapi, pas humbjes në xhiron e parë nga Drenica, synon t'i marrë pikë sot në ndeshjen ndaj Ballkanit në Suharekë. "Ndeshja ndaj Ballkanit do të jetë shumë e vështirë, por ne jemi duke u përgatitur për këtë përballje. Mendoj se do të marrim rezultat pozitiv", ka thënë Fiton Hajdari, sulmues i Llapit



EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 24 GUSHT - Skuadra e Llapit po shpreson të këndellet në xhiron e dytë të IPKO Superligës në futboll dhe të marrë rezultat pozitiv nga ndeshja ndaj Ballkanit. Kjo ndeshje do të zhvillohet sot (e shtunë) në Suharekë nga ora 16:45, kurse krahas saj zhvillohen edhe dy ndeshje të tjera: KEK-u - Gjilani dhe Drenica - Feronikeli. Fiton Hajdari, i rikthyer te skuadra e Llapit gjatë verës, ka thënë se janë bërë të gjitha përgatitjet e duhura për përballjen me skuadrën e rikthyer në elitë, Ballkanin. "Ndeshja ndaj Ballkanit do të jetë shumë e vështirë, por ne jemi duke u përgatitur për këtë përballje dhe mendoj se do të marrim rezultat pozitiv", ka thënë Hajdari.

Skuadra e Llapit që udhëhiqet nga strategu Bylbyl Sokoli, edhe përkundër ndryshimeve të shumta në afatin kalimtar të verës, nuk arriti të marrë pikë në ndeshjen e parë ndaj Drenicës, pasi pësoi humbje 0-1. Ndërsa Ballkani i rikthyer në elitë e mposhti në ndeshjen e parë Lirinë në stadiumin "Përparim Thaçi" në Prizren (0-1). Kapiteni Visar Berisha ka thënë për gazetë se në skuadrën nga Suhareka të gjithë po i presin tri pikët e radhës që do

të ishin të parat si vendës. Mbrojtësi në fjalë pret një numër të madh shikuesish në ndeshjen ndaj Llapit. "Ne jemi ekip i ri në Superligë, por me ambicie të larta për pjesën e epërme të tabelës. Ndeshjes ndaj Llapit do t'i qasemi seriozisht dhe synim e kemi t'i marrim tri pikët e plota. Ekipi është i kompletuar dhe atmosfera është mjaft e mirë. Jemi duke punuar me intensitet të lartë që ta nisim mirë edhe ndeshjen e parë si vendës. Presim një numër të madh të 'Xhebrailave'", ka deklaruar Berisha. Tri ndeshjet e tjera të javës së dytë zhvillohen të dielën, ndërsa spikat derbi në mes Trepçës '89 dhe Prishtinës. Kjo ndeshje do të zhvillohet në stadiumin "Riza Lushta", kurse para ndeshjes do të organizohet edhe ceremonia lamtumirëse e kapitenit Shpëtim Idrizi, i cili largohet nga futbollit i luajtur dhe më pas do ta vazhdojë karrierën në shtabin teknik të kësaj skuadre.

Fillon edhe Liga e Parë

Sot (e shtunë) fillon edhe edicioni i ri në Ligën e Parë të Kosovës në futboll. Sivjet ky rang garash pritet të jetë shumë interesant për faktin se në të bën pjesë Besa e Pejës dhe Vëllaznimi i Gjakovës. Pejanët do të luajnë ndaj Vllaznisë së Pozharanit, kurse Vëllaznimi i Gjakovës

do të ketë punë me Vushtrinë. Një tjetër skuadër që është përforcuar shumë gjatë verës, Dukagjini i Klinës do të luajë sot ndaj Fushë-Kosovës.

IPKO SUPERLIGA - JAVA E DYTË

Të shtunën takohen:
16:45 KEK-u-Gjilani
16:45 Drenica-Feronikeli
16:45 Ballkani-Llapi

Të dielën takohen:
16:45 Trepça '89-Prishtina
16:45 Ferizaj-Liria
16:45 Drita-Flamurtari

LIGA E PARË

Dukagjini-Fushë-Kosova
Ramiz Sadiku-Drenasi
Onix-2 Korriku

Të dielën takohen:
Vëllaznimi-Vushtrria
Arbëria-Bashkimi (K)
Kika-Istogu
Vllaznia-Besa

Të hënën takohen:
Vitia-Trepça

SHKURT

Ahmeti: UEFA ende s'ka vendosur për licencimin e stadiumit 'Fadil Vokrri'

Kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka njoftuar se UEFA ende nuk ka vendosur për licencimin e stadiumit "Fadil Vokrri", duke shtuar se përgjigja pritet të merret në ditët në vijim. "Me këtë raport punëkryesi ('Al Trade') dhe investitorët, MKRS-ja si investitore kryesore dhe Komuna e Prishtinës, presim të dimë se a ka nevojë për intervenime shtesë. Në qoftë se jo, atëherë edhe zyrtarisht fillojmë procedurën e pranimit teknik", ka shkruar Ahmeti. I pari i kryeqytetit ka njoftuar se më 2 shtator do të zhvillohet një ndeshje testuese në mes të Prishtinës dhe Drenicës, për t'i hapur rrugë ndeshjes në mes të Kosovës dhe Ishujve Faroe më 10 shtator. Sipas Ahmetit, kjo e fundit mund të realizohet vetëm nëse UEFA jep dritën e gjelbër për licencimin e stadiumit.

Kryeziu, nga Drita te Lugano

Reprezentuesi i Kosovës U19, Leotrim Kryeziu, nga Superliga e Kosovës është transferuar në Superligën e Zvicrës, përkatësisht te Lugano. 19-vjeçari që kampionatin e kaluar mbrojti ngjyrat e skuadrës së Dritës ka nënshkruar kontratë katërvjeçare me skuadrën e Luganos. "I falem Zotit që më ka mundësuar të jam ky që jam. I detyrohem pafund familjes sime të shenjtë që ka mbështetur çdo hap të karrierës sime, që nga filltet e formësimit gradual, edhe përkundër sfidave të shfaqura ndër vite. Jam shumë mirënjohës e falënderues për ambientin shumë familjar, pritjen e ngrohtë dhe klimën miqësore që më është ofruar te FC Lugano, për ç'gjë ndihem i privilegjuar. Shpresoj ta jap maksimumin tim, në funksion të sekseve të skuadrës së re", ka thënë Kryeziu.

Legjenda e Arsenalit: Xhaka mund të mbetet në bankë

Ish-mesfushori dhe kapiteni i Arsenalit, Ray Parlour, ka kritikuar paraqitjet e fundit të yllit shqiptar Granit Xhaka. "Xhaka po e humb shpesh topin në këtë sistemin e ri që po luan me mbrojtjen. Ai duhet të jetë më i lëvizshëm nëse mundet. Krahasuar me Matteo Guendouzi, i cili bëri përshtypje para sezonit, ai nuk është aq energjik apo i lëvizshëm. Nëse ai nuk bën punën e vet, Emery tashmë i ka treguar atij se ai do të largohet - ai e bëri atë kundër Chelseas pas pjesës së parë. Me Lucas Torreira, që unë mendoj se herët a vonë do të fillojë si titullar, Xhaka mund të lihet në bankë", ka deklaruar Parlour.

Ja pse e mban Ronaldo fanellën me numër 7

TORINO, 24 GUSHT - Të gjithë e dimë se fanella me numrin 7 e ka ndihmuar Cristiano Ronaldo të krijojë një brend global të CR7, i cili është i mirënjohur në botën e sportit. Fanella

me këtë numër nuk ka qenë e preferuara e Ronaldos. Ai para se të shkonte në Manchester United mbante fanellën me numër 28 te skuadra e Sportingut të Lisbonës. Por ka

qenë trajneri Sir Alex Ferguson i cili donte t'i jepte fanellën me numër 7 që e kishin mbajtur edhe ikona të klubit anglez. Këtë numër më parë e kishin mbajtur emra si Best, Cantona dhe

Beckham, dhe kjo tregonte besimin që tekniku kishte te portugezi. Kështu Ronaldo u miqësua me atë fanellë të cilën nuk e ndërroi as kur shkoi te Reali, së fundmi te Juventusit.



Osmani: Ta shkruajmë historinë në Ligën e Evropës



SHKUP, 24 GUSHT - Qatip Osmani ka folur pas humbjes së skuadrës tetovare ndaj Rosenborgut në kuadër të Ligës së Evropës. Shkëndija është mposhtur me rezultat 3-1 në takimin e parë të 'play-off'-it të Ligës së Evropës, në ndeshjen e luajtur në Norvegji. Megjithatë, sipas trajnerit Osmani, rezultati

nuk është pasqyrë reale e asaj që skuadrat shfaqën në fushën e lojës për 90 minuta. Osmani beson se kuqezinjtë merituan rezultat më të favorshëm dhe thotë se Shkëndija duhet të besojë në përmbysje në takimin e kthimit, më 30 gusht. "Bazuar në lojën e treguar mendoj se Shkëndija meritoi rezultat më

pozitiv por, megjithatë, shënuam golin që na jep shpresë se në takimin e kthimit do të mund të kualifikohemi në grupet e UEFA Ligës së Evropës", ka thënë Osmani, duke shtuar se: "Na pret ndeshje historike në Shkup dhe Shkëndija do të mundohet ta përmbysë rezultatit e ndeshjes së parë".

Alonso: Dy herë e kam refuzuar ofertën e Red Bullit



BRUKSEL, 24 GUSHT - Vazhdojnë polemikat mes pilotit spanjoll Fernando Alonso dhe makinës austriake Red Bull. Në pistën e Spasë, ku zhvillohet këtë fundjavë gara e Çmimit të Madh të Belgjikës në Formula 1, dy herë kampioni i botës ka thambuar drejtuesit e makinës austriake, se e kanë kërkuar dy herë, por në të dyja rastet përgjigjja e Alonso ka

qenë "JO". "Këtë sezon një ekip i madh më ka kërkuar dy herë, por kam thënë JO dhe në fund të këtij sezoni do të largohem, pasi ky sport nuk përcjell më emocionet e dikurshme", ka thënë Alonso që, i pyetur nëse ka qenë makina Red Bull që e ka kërkuar, ka thënë shkurtimisht: "Po!" Deklaratë e fortë kjo nga ana e pilotit spanjoll, që vijon polemikat që ai ka me

shefin e makinës austriake Christian Horner, që ka thënë se Alonso është një pilot që krijon kaos kudo që shkon, duke shtuar se do të afrojë një pilot të ri pas largimit të Daniel Ricciardos (do ta zëvendësojë Pierre Gasly). Megjithatë, Alonso ka konfirmuar se do të largohet nga Formula 1 në fund të këtij sezoni, pas 17 vjetësh.

SHKURT

Immobile i shpall "luftë" Ronaldos

Sulmuesi i Lazios, Ciro Immobile, pranoi se përballja me Cristiano Ronaldo do të jetë shumë e vështirë si në fushën e lojës, ashtu edhe në garën për t'u shpallur golashënuesi më i mirë i Serisë A. Portugezi kaloi nga Real Madridi te Juventus për 100 milionë euro. Immobile, i cili shënoi 41 gola në 47 ndeshje zyrtare me Lazion në sezonin e kaluar, u shpall golashënuesi më i mirë i Serisë A. "Në momentin që kalimi i Cristiano Ronaldo te Juventus u zyrtarizua, unë mendova: Falë Zotit isha në kohë për ta fituar 'këpucën e artë' në sezonin e kaluar. Do të jetë e vështirë ta mposhtësh atë në fushën e lojës dhe në garën për trofeun e golashënuesit më të mirë, por mua më pëlqejnë sfidat e vështira. Ronaldo e ka fituar shpesh këtë çmim dhe do të përpiqet të përsëritet në Itali", ka thënë Immobile.

Sot (e shtunë) Juventusit i Ronaldos do ta presë Lazion e Immobiles. Immobile shënoi në ndeshjen e parë kundër Napolit, pavarësisht se Lazio humbi, ndërsa Ronaldo "ngeci" përballë Chievos, pavarësisht se Juventusit fitoi. Te Real Madrid, Ronaldo shënoi 450 gola në 438 ndeshje zyrtare, më shumë se çdo futbolist tjetër në historinë e klubit "Los Blancos". Pesë herë fituesi i "Topit të Artë" fitoi 15 trofe te Real Madridit, mes të cilëve katër herë trofeun e Ligës së Kampionëve.

Bayerni zbret çmimin për Boatengun

Bayern Munchen ka zbritur çmimin për shitjen e mbrojtësit Jerome Boateng. "Kicker" ka njoftuar se klubi bavarez tani kërkon 30 milionë euro për largimin e yllit gjerman, në javën e fundit të afatit kalimtar të verës. Deri kohë më parë Bayern Munich kërkonte 40 milionë euro për shërbimet e Boatengut. Boatengu ka zgjuar interesim nga Paris Saint-Germain.

Ancelotti: Dua titullin me Napolin

Carlo Ancelotti është i bindur se me kualitetin që ka skuadra e Napolit dhe me përvojën e tij si trajner, titulli në Itali mund të fitohet. "Synimi im është ta çoj skuadrën në gradën më të lartë të kampionatit. Kam gjetur shumë kualitet te kjo skuadër, që për arsye të ndryshme nuk ia ka dalë ta fitojë titullin, por i ka shkuar shumë pranë. Gjithsesi, shpresoj se ky kualitet, duke i shtuar edhe përvojën time, ta sjellë titullin në qytetin e Napolit", ka thënë Ancelotti.

Ricciardo zbulon arsyen e largimit nga Red Bull

Lamtumira e Fernando Alonsos dhe kalimi i Daniele Ricciardos nga Red Bullit te Renaulti, ishin lajmet më të bujshme gjatë kësaj vere të Formulës 1. Ky i fundit ka shkaktuar edhe bujshëm më të madhe, por piloti australian e shpjegon kështu vendimin e tij. "Ishte një vendim i marrë pas një periudhe të gjatë reflektimi dhe sigurisht nuk ishte i lehtë. Kam pasur shumë pikëpyetje në mendje, që kur Max Verstappen rinovoi kontratën me skuadrën Red Bull. Mora kohën e nevojshme, por ndiheshja i gatshëm për një ndryshim dhe për një sfidë të re. Besoj se ka ende shumë të panjohura sa i përket kalimit te motorët Honda për vitin e ardhshëm në skuadrën austriake. Pa dyshim se ekziston një risk i lartë, sikurse ekziston edhe te kalimi im vitin e ardhshëm, por gjithsesi nuk është faktori kyç që më shtyu të ndryshoj ambient. Mbi të gjitha, doja një sfidë të re", ka thënë Ricciardo. Piloti australian ka pasur një bashkëjetesë të vështirë me holandezin Max Verstappen te Red Bullit, ndonëse skuadra i trajtonte të dy pilotët si të barabartë në pistë. Holandezi shquhet për stilin e tij aventurier të të garuarit dhe është bërë shpesh pjesë e incidenteve, ndërsa pakënaqësia e Ricciardos vjen pasi Verstappen ka rrezikuar edhe me manovrat ndaj shokut të skuadrës, duke rrezikuar të dalin të dy nga pista, në disa raste.



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
 MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJIS
 AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
 AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA
 ODRASLE
 AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr.329 /1
 Dt: 24.08.2018

Në bazë të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji nr.03/L -149, neni 12, paragrafi 4, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

Konkurs për "Marrëveshje për shërbime të veçanta"

Institucioni: Agjencia e Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur

Departamenti: Administratë Financa
Paga bruto: 497.75 €

Titulli i vendit të punës: Zyrtar për financa (1 vend pune)

Kohëzgjatja e kontratës: Deri nga kthimi i zyrtares nga pushimi i lehonisë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Detyrat kryesore:

- Harton planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësish dhe jep rekomandime lidhur me realizimin objektivave të njësish;
- Në bashkëpunim me mbikëqyrësin analizon dhe vlerëson realizimin e objektivave dhe planit të punës të njësish dhe harton raporte mbi progresin e arritur dhe rekomandon përmirësime nëse kërkohet;
- Analizon dhe vlerëson propozimet buxhetore të njësish buxhetore dhe bënë ekzaminimin e tyre mënyrë kritike duke shqyrtuar për korrektësinë, saktësinë dhe tërësinë si dhe kontribuon në përgatitjen e buxhetit përfundimtar për njësish buxhetore;
- Kryen edhe punë tjera profesionale në pajtim me qëllimin e vendit të punës të cilat mund të kërkohen kohë pas;
- Përgatitja e lëndëve dhe dërgimi i lëndëve në njësish e prokurimit në MASH-T-të;
- Përgatitja e pasqyrave mujore financiare;
- Bashkëpunon me zyrtar brenda Agjencisë së AAPAR-së;
- Përgatitja e të dhënave financiare;

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkua:

- Njohuri të thellë dhe të specializuar në fushën e financave publike dhe buxhet
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, PowerPoint, Access);
- Diplomë universitare .

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, të kenë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi mbetet i hapur 5 ditë kalendarike nga dita e publikimit në shtypin ditor.

Kandidatët aplikacionin (formularin për konkurrim) mund ta tërheqin në zyrat e Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (Ndërtesa MASH-T-II pranë Fakultetit Ekonomik dhe Juridik- kati i III-të, Rr. Agim Ramadani p.n, Prishtinë), duke filluar nga ora 8.00 deri në orën 16.00 po ashtu aplikacionet e plotësuar, duhet të dërgohen në këtë adresë.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten: Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, si dhe dokumentacione tjera të nevojshme sipas konkursit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
 Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
 Univerzitetske Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)
 Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)

Ref. nr. 39

Datë 22.08.2018

Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së duke u bazuar nën 13 pika 1 dhe 5 e Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës, nën 6 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik dhe Vendimit 01Nr. 60-87-93-1/2018 nr prot.4196/2 datë 16.08.2018 të Inspektoriatit të Punës, mori këtë:

V E N D I M

Bazuar në Vendimin 01Nr. 60-87-93-1/2018 nr prot.4196/2 datë 16.08.2018 e Inspektoriatit të Punës, i cili kërkon anulimin e përzgjedhjes për pozitën Drejtor i Qendrës Kombëtare të Mjekësisë së Punës në Gjakovë sipas numrit rendor tre (3) të Konkursit publik nr. 815 datë 22.05.2018, sepse nuk janë respektuar kriteret e konkursit dhe ka shkelje të dispozitave të Udhëzimit Administrativ 07/2017 për procedurat e konkursit në sektorin publik,

Prandaj, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së në bazë të kompetencave dhe Vendimit 01Nr. 60-87-93-1/2018 nr prot.4196/2 datë 16.08.2018 të Inspektoriatit të Punës, vendosi për anulimin e numrit rendor tre (3) të këtij konkursi gjegjësisht vetëm për pozitën Drejtor i Qendrës Kombëtare të Mjekësisë së Punës në Gjakovë.

Generalni Direktor UBKSK je na osnovu člana 13. stav 1 i 5. Statuta Univerziteta Bolnice i Kliničke Sluzbe Kosova, člana 6 Administrativno uputstvo br.07/2017 o regulisanje procedura konkursa na javnom sektoru i Odluke br. 01Nr. 60-87-93-1/2018 nr prot.4196/2 Dana 16.08.2018, od Inspektorat rada, je izdao ovo:

O D L U K U

Na osnovu Odluke br. 01Nr. 60-87-93-1/2018 nr prot.4196/2 Dana 16.08.2018, koja zahteva otkazivanje rednim brojem tri (3) Javnog Konkursa br.815 dana 22.05.2018, za ne poštovanje kriterijuma konkursa i kriterijum od Administrativno uputstvo br.07/2017 o regulisanje procedura konkursa na javnom sektoru

Generalni Direktor UBKSK na osnovu nadležnosti i Odluka br. 01Nr. 60-87-93-1/2018 nr prot.4196/2 Dana 16.08.2018, od Inspektorat rada, je odlučio da poništi serijski broj tri (3) ovog Konkursa koje samo za pozicije Direktor Nacionalnog Centar za Medicinu Rada Dakovica.

Vendimi i dorëzohet:

- Zyrës së DP-SHKSUK
- S.Personelit SHKSUK
- IP
- Arkivit

Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK
 Generalni Direktor UBKSK

Dr. Basmir Sejdiu

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Arben Koci nga Prishtina, shpallë të pavlefshme diplomën e Masterit të Kolegjit Globus-Prishtinë, me nr. 074/14.

► Arnisa Krasniqi Shala shpall të pavlefshme diplomën SHMGJ "Gjon Buzuku" Prizren

► Xhezair Krasniqi shpall të pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren

► Elbasane Krasniqi shpall të pavlefshme diplomën SHMM "Luciano Motroni" Prizren

► Sefedin Skenderi shpall të pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren

► Haxhi Salihu shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" në Gjakovë

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151

► Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një qift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

► Urgjentisht kërkoj banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

► Shes truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, truall frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lfti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, truall frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësorje me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

► Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

► Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesa e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE/ DIVIZION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazuar në Ligjin e Punës, Nr. 03/L-212 Ligji për Teatrot, Nr. 04/L-106 dhe Rregulloren Nr.05/2011, për Gradimin dhe Pagat e Krijuesve dhe Performuesve të Kulturës dhe të Punonjësve Professional të Trashëgimisë Kulturore, Udhezimin Administrativ Nr 07/2011 (MPMS) për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit rishpall :

KONKURS

Titulli i punës: Kostumograf /e

Institucioni: Teatri Kombëtar i Kosovës

Kategoria funksionale: Krijuesit dhe Performuesit e Kulturës- IX

Paga: Page fikse

Numri i referencës: 31/2018-R

I përgjigjet: Drejtorit të Teatrit Kombëtar të Kosovës

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Bën përgatitjen dhe të mbaruarit e skicës kostumografike;
2. Kryen në mënyrë studiuese përgatitjen për punë kostumografike për shfaqje, mbledhë dhe studion dokumentacionin në bazë të veprës;
3. Punon skicat e kostumeve, 7 maskave, këpucëve, cilindrave, aplikacioneve, stolive, armëve etj.;
4. Dorëzon skicën e plotë kostumografike për të marr leje nga komisioni pas konsultimit me regjisorin dhe scenografinë;
5. Prezanton në të gjitha provat në punëtorinë e rrobaqepësisë në skenën e teatrit;
6. Bën patinimin e kostumeve.

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

1. Diplomë e Fakultetit të Arteve, drejtimet dizajn i scenografisë, kostumografisë, pikturë, grafike ose ndonjë drejtim tjetër i fakultetit të arteve ;
2. Të ketë të realizuara kostumografitë, në 2 shfaqje, të paktën 1, në Teatrin Kombëtar të Kosovës (duhet dëshmuar me referenca nga regjisorët dhe kontrata);
3. Të ketë shkathhtësi komunikimi dhe aftësi të punës në presion;
4. Njohja e gjuhës Angleze është përparësi .

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin e lartë adekuat dhe kanë aftësi profesionale për kryerjen e detyrave.

Akte ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin: Ligjin e Punës, Nr. 03/L-212, Ligjin për Teatrot, Nr. 04/L-106 dhe Rregulloren Nr.05/2011, për Gradimin dhe Pagat e Krijuesve dhe Performuesve të Kulturës dhe të Punonjësve Professional të Trashëgimisë Kulturore dhe Udhezimin Administrativ Nr 07/2011 (MPMS) për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik.

Kohëzgjatja e emërimit: Kandidati që pranohet, përmes Konkursit publik, merr kontratë 6 mujore për periudhën provuese, me mundësi të vazhdimit sipas suksesit dhe angazhimit të treguar.

Dokumentet e nevojshme që kërkohen:

Kandidatët duhen të dorëzojnë dokumentet e kompletuara si vijon:

- Diplomë e fakultetit të arteve, drejtimi- Dizajn i scenografisë dhe kostumografisë ;
- Dëshmitë me referenca nga regjisorët dhe kontrata, për 2 shfaqje të realizuara, të paktën 1, të realizuar në Teatrin Kombëtar të Kosovës;
- Dokumenti i identifikimit.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi është i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë pas ditës së shpalljes.

Data e fundit e aplikimit është: 08.09.2018

Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacioni shkarkohet nga Ueb faqja e MKRS-së dhe dorëzohet në Zyrën 27 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sheshi "Nëna Tereze" Nr. 44. Për informata shtesë kontaktoni në numrat 038 211 921 dhe 038 211 449, apo në ueb-faqen <http://www.mkrs-ks.org/>



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE/ DIVIZION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Na osnovu Zakona o Radu, Br. 03/L-212, Zakona za Pozorišta, Br. 04/L-106 i Uredbe Br. 05/2011 za Stepenovanje i Plaćanje Stvaralaca i Izvođača Kulture i Profesionalnih Radnika Kulturnog Nasleđa, i Administrativno Uputstvo (MRSZ) Br. 07/2017, o Regulisanju Procedura Konkursa na Javnom Sektoru, Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta, objavljuje:

KONKURS

Naziv radnog mesta: Kostimograf

Institucija: Nacionalno Pozorište Kosova

Funkcionalna kategorija: Stvaraoci i izvođači kulture - IX

Plata: Fiksna plata

Broj upućivanja: 31/2018-R

Odgovara: Direktor Nacionalnog Pozorišta Kosova

Dužnosti i odgovornosti:

1. Priprema i finalizuje kostimografsku skicu;
2. Na istraživački način priprema kostimografske radove za predstave, prikuplja i pročava dokumentaciju na osnovu dela;
3. Radi skice kostima, maska, cipela, cilindara, aplikacija, nakita, oružja, itd;
4. U potpunosti kostimografsku sliku dostavlja za dobijanje dozvole od komisije, nakon izvršenih konsultacija za režiserom i scenografom;
5. Na svim probama radionice krojača predstavlja na pozorišnoj sceni;
6. Vršiti ispravke kostima.

Traženo obrazovanje, iskustvo, sposobnosti i lične karakteristike:

1. Diploma Fakulteta Umetnosti, pravci, dizajn scenografije, kostimografije, slike, grafike ili neki drugi pravac fakulteta umetnosti;
2. Da je realizovao/a 2 predstave, a najmanje 1, pri Narodnom pozorištu Kosova (mora se dokazati preporukama režisera i ugovorom);
3. Da je komunikativna osoba i da poseduje sposobnosti rada pod pritiskom;
4. Poznavanje engleskog jezika je prednost.

Uslovi učešća na konkursu: Pravo na apliciranje imaju svi državljani Republike Kosova odraslog godišta, koji su sposobni da rade, koji su završili visoko adekvatno obrazovanje i koji poseduju profesionalne sposobnosti za vršenje dužnosti.

Zakonski i podzakonski akti koji regulišu zapošljenje: Zakon o Radu, br. 03/L-212, Zakon o Pozorištima, Br. 04/L-106, Uredba br. 05/2011, za Stepenovanje i Plaćanje Stvaralaca i Izvođača Kulture i Profesionalnih Radnika Kulturnog Nasleđa, i Administrativno Uputstvo (MRSZ) Br. 07/2017, o Regulisanju Procedura Konkursa na Javnom Sektoru.

Trajanje imenovanja: Kandidati koji se prime putem javnog konkursa dobijaju ugovor na 6 meseci (probni rad), sa mogućnošću produženja po uspešnom angažovanju.

Dokumenti koji se zahtevaju:

Kandidati trebaju dostaviti sledeća upotpunjena dokumenta:

- Diplomu fakulteta umetnosti – smer dizajna scenografije i kostimografije;
- Dokaz i preporuke režisera i ugovor da je realizovao/la 2 predstave, najmanje 1, pri Narodnom pozorištu Kosova;
- Identifikacioni dokumenti.

Datum zatvaranja konkursa: Konkurs je otvoren petnaest (15) dana od datuma objavljivanja.

Poslednji dan apliciranja je: 08.09.2018

Aplikacije koje se dostave putem pošte, poštanskom markicom, na poslednji dan konkursa, smatraće se važećim.

Podnošenje zahteva: Aplikacija se preuzima sa veb stranice MKOS-a i dostavlja u kancelariji 27, ministarstva kulture, omladine i sporta, Trg "Majke Tereze", br. 44. Za dodatne informacije stupite u kontakt na brojeve telefona 038 211 921 i 038 211 449, ili na veb stranici (<http://www.mkrs-ks.org/>)



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë
Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health

Divizioni i Burimeve Njerëzore / Divizija za Ljudske Resurse / Human Resources Division

SHPALLJA E REKRUTIMIT

Institucioni:	Ministria e Shëndetësisë
Departamenti:	Departamenti për Zhvillim Strategjik Shëndetësor
Titulli i vendit të punës:	Udhëheqës i Divizionit të Cilësisë dhe Sigurisë së Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësorë
Kategoria funksionale/Grada:	Koeficienti - 9
Afati i kontratës:	Nëpunës i karrierës – me kohë të paktuar
Nr. i Referencës:	MSh-13/08/18

Detyrat kryesore:

- Menaxhon punën e përgjithshme të divizionit dhe ndihmon drejtorin në caktimin e objektivave dhe zhvillimin e planit të punës për përbushjen e këtyre objektivave si dhe harton planin e punës për divizionin; 15%
- Menaxhon stafin e divizionit dhe në bashkëpunim me mbikëqyrësin, organizon punën përmes ndarjes së detyrave tek të varurit, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit për ofrimin e produkteve dhe shërbimeve cilësore; 10%
- Në bashkëpunim me drejtorin, bën vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime dhe përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës; 10%
- Monitoron dhe ofron mbështetje në koordinimin e funksionimit të institucioneve shëndetësore duke siguruar cilësi dhe siguri të shërbimeve të kujdesit shëndetësorë në Kosovë; 10%
- Siguron ndërlidhjen e shërbimeve publike dhe private shëndetësore në fushën e cilësisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësorë të ofruara nga organizatat qeveritare dhe jo qeveritare (përmes projekteve të ndryshme; 15%
- Ndihmon në hartimin e politikave/strategjive dhe legjislacionin që ka të bëjë me shërbimet e cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësorë; 10%
- Monitoron dhe raporton mbi aktivitetet e shërbimeve për cilësinë dhe sigurinë e shërbimeve të kujdesit shëndetësorë; 15%
- Ofron mbështetje në zhvillimin profesional të burimeve njerëzore në sektorin e shëndetësisë me qëllim të rritjes së cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësorë 10%
- Bën vlerësimin e rregullt të stafit nën mbikëqyrje e tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimit për kryerje të detyrave të tyre në përputhje me standardet e kërkuara; 5%

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Procedurat e konkurrimit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Shkollimi i kërkuar: : Diplomë universitare në mjekësi - dega e mjekësi e përgjithshme.

Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- Së paku 5 vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri e shkëlqyeshme e kartës së të drejtave të qytetarëve;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme lidhur me shëndetësinë;
- Aftësi komunikuese, negociuese dhe bindëse në menaxhim;
- Shkathtësi në caktim të objektivave, planifikim të punës dhe analizë;
- Shkathtësi në udhëheqje dhe organizim të ekipit, aftësi për të menaxhuar një ekip ose grup punues;
- Njohja e punës me kompjuter, programeve: Word-it, Excel-it, Power Point-it, Internetet

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin: Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr. 02/2010 Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kohëzgjatja e emërimit: Nëpunës i karrierës, pa afat të caktuar.

Data e hapjes dhe mbylljes së konkursit: 25.08.2018 deri 08.09.2018

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren recepcion ose në faqen zyrtare të ministrisë, dhe dorëzohen në zyrën nr. 23 të Ministrisë së Shëndetësisë, Lagja Arbëria, rrua e Zagrebit p.n. (ish Spitali i mushkërive). Në aplikacion duhet të cekët qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës. Kontaktet me telefon mund të bëni në 038 212-276.

"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike, qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës".

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë
Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health

Divizioni i Burimeve Njerëzore / Divizija za Ljudske Resurse / Human Resources Division

OGLAS ZA REGRUTOVANJE

Institucija:	Ministarstvo zdravstva
Departman:	Departman za zdravstveni strateški razvoj
Naziv radnog mesta:	Rukovodilac Divizije za kvalitet i bezbednost usluga zdravstvene zaštite
Funkcionalna kategorija/Gradiranje:	Koeficijent- 9
Rok ugovora:	Karijerni službenik- na neodređeno vreme
Br.reference:	MZ-13/08/18

Glavni zadaci :

- Upravlja ukupnim radom Divizije i pomaže direktoru u postavljanju ciljeva i razvoju radnog plana za ispunjavanje ovih ciljeva i izrađuje plan rada Divizije; 15%
- Rukovodi osobljem Divizije i u saradnji sa nadzornikom organizuje poslove preko podele zadataka podređenim zvaničnicima, pruža uputstva i nadgleda rad osoblja kako bi se obezbedili produkti i kvalitetne usluge; 10%
- U saradnji sa direktorom procenjuje procese i unutrašnje procedure i preporučuje izmene i dopune u cilju povećanja poslovnog efikasiteta; 10%
- Nadgleda i pruža podršku u koordinaciji funkcionisanja zdravstvenih ustanova obezbedujući kvalitet i bezbednost usluga zdravstvene zaštite na Kosovu; 10%
- Osigurava povezanost javnih i privatnih zdravstvenih usluga iz oblasti kvaliteta zdravstvenih usluga koje pružaju vladine i nevladine organizacije (preko raznih projekata); 15%
- Pomaže u izradi politika / strategija i zakonodavstva koje se odnose na kvalitet i bezbednost usluga zdravstvene zaštite; 10%
- Nadgleda i izveštava o aktivnostima službi za kvalitet i bezbednost usluga zdravstvene zaštite; 15%
- Pruža podršku profesionalnom razvoju ljudskih resursa u zdravstvenom sektoru kako bi se povećao kvalitet i poboljšala bezbednost usluga zdravstvene zaštite; 10%
- Redovno vrši vrednovanje podređenog osoblja i podržava njihov razvoj preko obuka kako bi se obezbedio nivo zahtevanih standarda u izvršenju poslova; 5%

Uslovi učešća u regrutovanju: Pravo aplikacija imaju svi punoletni državljani Republikë Kosova koji imaju punu poslovnu sposobnost, koji su završili zahtevano školovanje i imaju profesionalnu sposobnost u obavljaju poslova.

Procedure konkurisanja: Konkurs je otvoren za sve zainteresovane kandidate.

Zahtevano školovanje: Univerzitetska diploma iz medicinske oblasti - smer opšte medicine.

Sposobnosti / iskustvo i drugi zahtevani atributi :

- Najmanje pet (5) godina profesionalnog radnog iskustva;
- Odlično poznavanje povelje o gradanskim pravima;
- Poznavanje važećih zakona i pravilnika u vezi sa zdravstvom;
- Sposobnost komuniciranja, pregovaranja i postizanja ubedljivosti u upravljanju;
- Sposobnost u utvrđivanju ciljeva, planiranja rada i analiziranja;
- Sposobnost u rukovođenju i organizovanju ekipe, sposobnost upravljanja ekipom ili radnom grupom;
- Poznavanje rada na kompjuteru u primeni programa: Word, Excel, Power Point, Interneta;

Zakonski i podzakonski akti koji regulišu regrutovanje : Na osnovu Zakona br. 03/L-149 o civilnoj službi na Kosovu kao i Uredbe br .02/2010 o proceduri regrutovanja u javnoj službi.

Trajanje imenovanja: Karijerni službenik, na neodređeno vreme.

Datum publikacije i zatvaranja konkursa: 25.08.2018 do 08.09.2018

Prijave aplikacija: Aplikacije se mogu dobiti na recepciji ili preuzeti sa web stranice ministarstva i dostaviti u kancelariju br. 23 Ministarstva zdravstva na adresi: naselje Arberija, ulica "Zagrebačka" b.b. (bivša plućna bolnica). U aplikaciji jasno navedite naziv radnog mesta i broj reference. Kontaktirati na telefon : 038 212 -276.

"Civilna služba Kosova pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova, i prima aplikacije od osoba muškog i ženskog roda iz svih zajednica na Kosovu.

Nevećinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo na proporcionalnu zastupljenost u civilnoj službi javne administracije, centralne i lokalne, kako je predviđeno u članu 11, stav 3 Zakona br.03-L-149 o civilnoj službi Republike Kosova".

Nekompletirane prijave i prijave nakon isteka roka neće se uzimati u obzir. Zbog prevelikog broja primljenih prijava, kontaktiraće se samo oni kandidati koji su izabrani u užem krugu.

NPL "STACIONI I AUTOBUSEVE" SH.A.
FERIZAJ
Nr. 144 Data 24.08.2018

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLICA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
STACIONI I AUTOBUSEVE SH.A.
FERIZAJ

Në bazë të nenit 17 pika 1 dhe 2, si dhe nenit 21 të Ligjit për Ndërmarrjet publike nr.03/L-087, nenit 14 të statutit, Bordi i Drejtorëve i NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a Ferizaj në mbledhjen e mbajtur me datën 22.08.2018, vendosi që me datë 24.08.2018 të shpall këtë:

KONKURS

Pozita e punës: Zyrtar i/e Lartë Financave dhe Thesarit
Vendi: Ferizaj

Detyrat dhe përgjegjësit:

- Harmonizimi i llogarive, kategorive të pagave dhe tarifave
- Organizimi i departamentit të kontabilitetit duke përfshirë ngritjen e strukturës së qendrës së shërbimeve
- Të përmirësoj dhe të mbaj nën kontroll grumbullimin e të ardhurave vjetore të njësisë operative
- Llogaritjen e shpenzimeve dhe kontabilitetit i listave të pagave
- Përgaditja në kohë e raporteve (Sistemi i informimit të menaxhmentit, drejtuari menaxhmentit të ndërmarrjes, Bordi mbikqytës, autoritet fiskale dhe ligjore)
- Përgatitja e planeve afariste dhe objektivat krahasimi aktual

Kualifikimi dhe aftësitë:


- Kandidatët kërkohej diplomë universitare-Fakulteti Ekonomik.
- Të ketë 5 vite përvojë pune në profesion.
- Të mos jetë nën hetime për veprë penale.

Procedura e aplikimit:
Dokumentat e nevojshme për aplikim:

- CV-ja (Biografia).
- Diploma e fakultetit- kopje
- Certifikatat mbi kualifikimet dhe trajnimet;
- Dëshmi mbi përvojën e punës;
- Kopja e letër njoftimit,
- Letër motivimi,
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se 3 muaj.
- Deklaratën nën betim (formular i cili plotësohet në momentin e dorzimit të dokumentacionit)

- Kandidati për këtë pozitë përzgjidhet nga Bordi i Drejtorëve për mandatin prej 3 (tre) vitesh. Bordi i Drejtorëve mund në çdo kohë dhe me shumicë votash ta ndërpresë kontratën e punës me ose pa deklarinim e arsyes.
- Kompenzimet dhe përfitimet për këtë pozitë do të përcaktohen nga Bordi i Drejtorëve të NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a Ferizaj në pajtim me aktet ligjore, statutin dhe politikën e NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a Ferizaj.
- Kandidatët për këtë pozitë duhet të jenë persona me integritet të njohur, të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit, kriteret e pavarësisë, të kenë përvojë të nevojshme profesionale, shkollimin e kërkuar dhe kushtet tjera në pajtim të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike.
- Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit për aplikim, ndërsa NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a Ferizaj mban të drejtën e formimit të listës së shkurtër me aplikant.
- Kandidatët e interesuar për punësim mund të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar në Zyrat e NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a Ferizaj, në zarf të mbyllur.
- Afati i konkursit është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në web faqen zyrtare të NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a Ferizaj, në tabelën e shpalljeve si dhe në shtypin ditor, duke filluar prej 24.08.2018 deri më 07.09.2018 në orën 16:00.

Kryesuesi Bordit të Drejtorëve
Albrim Bytyqi



NPL "STACIONI I AUTOBUSEVE" SH.A.
FERIZAJ
Nr. 145 Data 24.08.2018

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLICA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
STACIONI I AUTOBUSEVE SH.A.
FERIZAJ

Në bazë të nenit 17 pika 1 dhe 2, si dhe nenit 21 të Ligjit për Ndërmarrjet publike nr.03/L-087, nenit 14 të statutit, Bordi i Drejtorëve i NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a Ferizaj në mbledhjen e mbajtur me datën 22.08.2018, vendosi që me datë 24.08.2018 të shpall këtë:

KONKURS

Pozita e punës: Zyrtar i/e Lartë – Sekretar/e të Kompanisë
Vendi: Ferizaj

Detyrat dhe përgjegjësit:

- Administrimi i punëve të të gjithë sektorëve të ndërmarrjes
- Organizon dhe mirëmban sistemin dhe përgaditjen e dokumenteve
- Siguron rrjedhjen efiçase të punëve në administratë
- Përgadit letrat zyrtare dhe raportet
- Ka përgjegjësi për menaxhimin e personelit
- Siguron mbarëvajtjen e punës të B.D
- Përfaqson kompaninë në rastet gjyqësore

Kualifikimi dhe aftësitë:


- Kandidatët kërkohej diplomë universitar-Fakulteti juridik.
- Të posedoj 5 vite përvojë pune në profesion.
- Të mos jetë nën hetime për veprë penale.

Procedura e aplikimit:
Dokumentat e nevojshme për aplikim:

- CV-ja (Biografia).
- Diploma e fakultetit- kopje
- Certifikatat mbi kualifikimet dhe trajnimet;
- Dëshmi mbi përvojën e punës;
- Kopja e letër njoftimit,
- Letër motivimi,
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se 3 muaj.
- Deklaratën nën betim (formular i cili plotësohet në momentin e dorzimit të dokumentacionit)

- Kandidati për këtë pozitë përzgjidhet nga Bordi i Drejtorëve për mandatin prej 3 (tre) vitesh. Bordi i Drejtorëve mund në çdo kohë dhe me shumicë votash ta ndërpresë kontratën e punës me ose pa deklarinim e arsyes.
- Kompenzimet dhe përfitimet për këtë pozitë do të përcaktohen nga Bordi i Drejtorëve të NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a Ferizaj në pajtim me aktet ligjore, statutin dhe politikën e NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a Ferizaj.
- Kandidatët për këtë pozitë duhet të jenë persona të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit, kriteret e pavarësisë, të kenë përvojë të nevojshme profesionale, shkollimin e kërkuar dhe kushtet tjera në pajtim të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike.
- Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim, ndërsa NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a Ferizaj, mban të drejtën e formimit të listës së shkurtër me aplikant.
- Kandidatët e interesuar për punësim mund të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar në Zyrat e NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a Ferizaj, në zarf të mbyllur.
- Afati i konkursit është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a Ferizaj, në tabelën e shpalljeve si dhe në shtypin ditor, duke filluar prej 24.08.2018 deri më 07.09.2018 në orën 16:00.

Kryesuesi Bordit të Drejtorëve
Albrim Bytyqi



NPL "STACIONI I AUTOBUSEVE" SH.A.
FERIZAJ
Nr. 144 Data 24.08.2018

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLICA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
STACIONI I AUTOBUSEVE SH.A.
FERIZAJ

